VLERA

REVISTË PËR FAMILJE DHE SHOQËRI



Dita e Shpalljes
fq 4

Naim Frashëri
prijësi shpirtëror
fq 32

Kurani *dhe*
Psikoterapia
fq 44

Studenti
Ateist
fq 46

Ditëlindja
e Imam Husejnit
fq 8

PRISHTINË * NR.29 * MAJ/QERSHOR 2019 * WWW.REVISTAVLERA.NET * ÇMIMI 1EUR

PËRMBAJTJA



Dita e Shpalljes

FQ 4



Ditëlindja e Imam Husejnit

FQ 8



Naim Frashëri Prijës Shpirtëror

FQ 32



Si edukohen fëmijët?

FQ 34



Kurani dhe psikoterapia

FQ 44



Studenti Ateist

FQ 46

VLERA

KRYEREDAKTORE:
Msc.Ikballe Berisha Huduti
ikballebh@gmail.com
www.ikballebh.com
Mob: +377 44 142 038

REDAKTORE:
Mr. Valentina Shala

REDAKSIA:
Mr. Iris Robaj
Dr. Emine Goxhuli
Fehmi Maliqi
Zehra Huduti
Adelina Rama

DESIGN:
MM

ADRESA:
Rr.Rrustem Statovci 25
Prishtinë 10000
E-mail: vlera.magazine@gmail.com
www.revistavlera.com
Botoi: Shtëpia Botuese
"Dielli Pas Reve"

YouTube
Dielli Pas Reve

SPONSORED BY:

THE WORLD FEDERATION
OF KHOJA SHIA ITHNA-ASHERI MUSLIM COMMUNITIES

Trimëresha

Fjalët e tua zunë vend
Në zemrat tona të pikëlluara
Tani shpirti ynë i dobët
Thur mjerim për ditët e shkuara
Iu bashkua vëlla Husejnit
Në gëzim e hidhërim
I përballoi të ligat e jetës
Për hir të Islamit dhe të Vërtetës
Ju mizorë të pashpirt
Ju shpirtligë e jezidë
Menduat se bëtë trimëri
Mbytët bijtë e Muhammedit
Shembulli i zjarrtë në histori
Është Zejnebja, bija e Aliut
Trimëresha e Qerbelasë
Mbesa e dashur e Muhammed Mustafasë

Autor : Ikballe Berisha Huduti





Dita e Shpalljes

JEWMUL-MEB'ATHMË

Rexhep sipas kalendarit hënor (ose data 28 qershor 610, 13 vite para Hixhretit), në këtë ditë, Muhamedi, djali i Abdullahut (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) u përzgjodh nga Zoti i Madhëruar si profet. Ai ishte në moshën 40-vjeçare, në shpellën "Hira", te Mali i Dritës (arab. Xhebelun-Nūr) në afërsi të qytetit të Mekës.

Cila ishte shpallja e parë dhe e dytë?

Gjersa ishte duke medituar dhe lutur për misionin e tij si profet i Islamit, iu shpallën pesë vargjet (arab. ājet) e para të kaptinës (arab. sūreh) el-Alek (Ngjizja):

"Lexo! Në emrin e Zotit tënd që krijoi,
Krijoi njeriun nga zgjizja,
Lexo! Se Zoti yt është Bujar,
I Cili e mësoi (njeriun) të shkruaj me penë,
Ia mësoi njeriut atë çka ai nuk e dinte".
(Kurani i Shenjtë, surja el-Alek, ajetet 1-5)

Më pas iu shpallën edhe ajetet e para të sures el-Muddethir (I mbështjelluri):
"O ti i mbështjellë!
Çohu dhe paralajmëro!
Zotin tënd madhëroje,
Petkat e tua pastoji,
Dhe largohu nga ndyrësia".
(Kurani i Shenjtë, surja el-Muddethir, ajetet 1-5)

Me çfarë emri njihet kjo festë?

Përvjetori i fillimit të misionit të Profetit Muhamed (pqmtf) është ndër festat e mëdha të muslimanëve, dhe kjo ditë e bekuar njihet me emrin "Dita e Shpalljes" ose "Jewmul-Meb'ath".

Ç'është meb'ath-i?

Meb'ath – do të thotë dërgimi i një njeriu nga Zoti për t'i ftuar njerëzit dhe për t'i udhëzuar në rrugën e drejtë. Ky term përdoret kryesisht për Muhamedin (pqmtf) kur ai u zgjodh profet.

Meb'ath-i në Kuranin e Shenjtë

Ky term në Kuranin e Shenjtë tregon një fazë të veçantë të jetës e cila ka një lloj transformimi pra përveç kuptimit të të bërit profet, ajo gjithashtu i referohet ringjalljes në botën e përtejme. Megjithatë, kuptimi dominues është përzgjedhja dhe dërgimi i dikujt si profet. Në të gjithë Kuranin e shenjtë ky term i atribuohet gjithmonë Zotit, si: ringjallja në botën tjetër, rregulla të veçanta të universit dhe dërgimi i profetëve, pra të gjitha këto tregojnë fuqinë e Zotit dhe programin e Tij në sundimin e botës.

Një nga pikat e rëndësishme në lidhje me meb'athin është se Zoti vazhdimisht e ka bekuar njerëzimin duke i dërguar profetë dhe ky bekim mund të shihet nga dy aspekte:

- **Dërgimi në aspektin e udhëzimit të njerëzimit,**

- **Profetët janë zgjedhur midis njerëzve që të jenë të njëjtit lloj.**

Meb`'ath-i sipas Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij)

Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) ka thënë: "Jam dërguar profet për t'i përsosur virtytet e moralit".

Meb'ath-i sipas veprës "Nehxhul-Belaga" të Imam Aliut


Sipas asaj që përmendet në veprën "Nehxhul-Belaga" të Imam Aliut (paqja qoftë mbi të), arabët para fillimit të misionit të Profetit Muhamed (pqmtf) përshkruen si:

"Vërtet! Allahu e dërgoi Muhamedin (pqmtf) si përkujtues për të gjitha botët dhe si lajmëtar të shpalljes, gjersa ju, o arabë, keni ndjekur fenë më të keqe dhe keni banuar në vendbanimin më të keq, mes shkëmbinjve dhe keni ngrënë ushqim të papastër. Keni derdhur gjakun e njëri-tjetrit dhe nuk i keni kushtuar kujdes farefisnisë. Idhujt janë përqëndruar mes jush, ndërsa mëkatet iu kanë qepur pas". (Imam Aliu, "Nehxhul-Belaga", fjalimi 26)

Pozita e kësaj dite në kulturën islame

Kjo ditë ka një pozitë shumë të lartë në mesin e muslimanëve. Në fakt është pika fillestare e Islamit, sepse fillimisht kishte pak pasues dhe rrethana të vështira dhe më pas u zgjerua në të gjithë botën dhe tërhoqi shumë zemra. Sipas historianëve, kjo ngjarje ndodhi ditën e hënë, më 27 Rexhep në vitin e katërdhjetë pas vitit të Elefantit dhe trembëdhjetë vjet para Hixhretit (28 qershor 610).

Redaksia VLERA ju uron gjithë muslimanëve kudo që janë këtë ditë të gëzuar duke jetuar në lumturi dhe paqe.





Ditëlindja e

Hazret Abbasit

Lindja e tij

Në ditën e katërt të muajit Sha'ban të vitit 26 pas Hixhretit/Emigrimit të Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) nga Meka në Medine, lindi Abbasi, nga nëna Hazreti Fatime bint Hizam dhe babai Hazreti Aliu (paqja qoftë mbi ta) në qytetin e Medines. Ai ishte djali më i madh nga tre fëmijët që i kishte Imam Aliu me Hazreti Fatime bint Hizam. Nga martesa me Hazreti Labaden, ai kishte tre djem, Fadlin, Muhamedin dhe Ubejdullahun.

Vepra e tij

Vepra e tij është shumë e pasur edhe pse jetoi shumë pak në këtë jetë (jetoi vetëm 33 vjet). Mori pjesë në disa beteja vendimtare për shpëtimin e fesë islame nga armiqtë e brendshëm. Shembull në betejën e Siffinit mori pjesë së bashku me babain e tij, dhe për t'ia ngritur personalitetin e tij, Imam Aliun i tha: **"Ai është Abbasi, hëna e Hashimitëve".**

Gjithashtu mori pjesë në tragjedinë e Qerbelasë ku ishte caktuar nga Imam Husejni që t'i jepte ujë fëmijëve. Gjatë tragjedisë së Qerbelasë, me vete kishte vetëm një shtizë dhe një çantë për ujë. Në anën e lumit Eufrat kishte me qindra ushtarë të armikut që e bllokonin lumin për të pirë ujë muslimanët. Edhe pse ishte tejet i etur, ai nuk pinte ujë, por ujin që e mori iu dërgoi fëmijëve në kamp. Rrugës për në kamp ai u sulmua me shigjeta nga ushtarët e Jezidit, dhe kështu, ai u martirizua më 10 tetor 680 ose 10 muharrem të vitit 61 pas Hixhretit (Emigrimit të Profetit Muhamed [pqmtf] nga Meka në Medinë). Hazret Abbasi la pas vetes shtatë fëmijë, pesë djem: Ubejdullahun, Fadlin, Hasanin, Kasimin dhe Muhamedin, dhe dy vajza.

Përkujtimi

Ai u varros pranë lumit Eufrat dhe u quajt "Heroi i Eufratit". Sot mauzoleu dhe xhamia e tij gjendet në qytetin Kerbela, në afërsi të mauzoleut dhe xhamisë së Imam Husejnit. Gjithashtu edhe Komuniteti Musliman Bektashian e përkujtojnë Hazret Abbasin çdo vit më 22 deri 25 gusht në malin Tomor në Berat të Shqipërisë.

Urime ditëlindja
e Hazret Abbasit!

Abaz Aliu

Naim Frashëri

Engjëll! që m'u qasë pranë
Nga i madhi Zot,
Pse më rrëfen Qerbelanë?
A do të derth lot?
moj fush'e Qerbelasë!
Që më rri ndër sy,
Plot me gjak t'Ali-Abasë,
Vallë ç'ësht' ay?
Ç'ësht' ay që shkon kaluar,
Ikën si veriu,
Me dy-tri foshnja nër duar?
Ësht' Abas-Aliu!
Shpije foshnjatë në lumë,
Se s'durojnë dot,
I ka marrë etja shumë,
E qajnë me lot!
Ujët ua kanë prerë
Janë në shtrëngim,
Si të varfër e të mjerë.
Në zi, në hidhërim.
Më ç'do an' i ka rrethuar
Kombi faqezi,
Komb'i lik i xnallëkuar,
Posi mizëri!
Nëpër mest të ushtrisë
Të armikut shkon,
Si ëngjëll i Perëndisë,
Nd'erë fluturoni
Shigjetat si breshërimë
I vinë ngado,
Ay po si vetëtimë
Ikën nëpër 'to.



Naim Frashëri

Shërbtor'e njerëzisë
Shigjeta s'e çpon
Edhe nder'e trimërisë
Zoti e mburon.
Ç'ikën ay kal'i shkretë,
Mi dhë nuk shkel
Nga potkonjtë q'ikën shpejtë
Zjar e flak'i del!
moj kafshëz e uruar,
Mos shkel për mi dhë.
Se'shtë gjaku i bekuar,
Ikë nëpër rë!
Frat, o more lum'i shkreti
Mos këndo pa qaj,
Derth lot e rënko për jetë,
Mos qesh paskëtaj;
Se Hysejn'e Fatimesë
Me faret të ti,
E vranë komb'i pabesë,
Kombi faqezi.
Abas Aliu zu' Tomorë,
Erdhi afër nesh,
Shqipërija s'mbet e gjorë,
Se Zoti e desh.
Hysejni desh njerëzinë,
Dhe për të u vra,
Për të shpëtuar njerinë
Ra nde Qerbela.
Hysejni 'shtë dashurija
Që fatbardhëson,
Buron soje miqësija,
Qe na lartëson.
Jeziti 'shtë egërsirë,
Që sjell ligësi,
Dhe s'del soje pun'e mirë
Po dëm edhe zi.
Kushdo që bën mirësinë
E ka njerëzi
Ka besuar Alinë,
Dhe udhën e ti.
Gënjeshtra 'shtë Mavijeja,
Që prish edhe sot,
E drejta 'shtë Fatimja,
Dhe i madhi Zot.
E liga është Mervani
Që nxin e shkretën,
Djallëzija 'shtë Syfjani,
Që dhe sot dërmon.
Imamëtë dymbëdhjetë
Nga der'e Aliut,
Hoqn'e vuanë ndë jetë
Por nder të njeriut.
Zotërinj! ju qofsha falë!
Që hoqtë për ne,
Na latë vetëm një fjalë
Për bes'e fe.

Ditëlindja e Imam

Më 3 Sha'ban sipas kalendarit hënor (ose data 10 tetor 625, katër vite pas Hixhretit) ka lindur Husejni, djali i Aliut (paqja qoftë mbi ta). Husejni është imami tretë me radhë i Ehli Bejtit (Shtëpisë së Profetit Muhamed, paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij).

Lindja e tij

Në ditën e tretë të muajit Sha'ban të vitit të katërt pas Hixhretit (Emigrimit të Profetit nga Meka në Medine) lindi Husejni, nga nëna Hazreti Fatime dhe babai Hazreti Aliu (paqja qoftë mbi ta). Kur Profeti Muhamed (pqmtf) mori vesh për lindjen e nipit të tij, i tha Imam Aliut: "Quaje Husejn".

Pozita e tij

Pozita e Imam Hujsenit përveç ajeteve kuranore të cilat përmendin pozitën e tij së bashku me pozitën e Ehli Bejtit (a.s.) po ashtu hadithet e Profetit Muhamed (pqmtf) janë të shumta rreth kësaj çështjeje, po ashtu për të përmenden ngjarje të ndryshme besimshtytëse. Disa nga to janë:

1. Profeti Muhamed (pqmtf) për Imam Husejnin ka thënë: **"Husejni është prej meje dhe unë jam prej Husejnit. Allahu e do atë që e do Husejnin. Husejni është degë prej degëve të pemës së Ehli Bejtit".**

2. Një ditë Imam Husejni kaloi pranë disa varfanjakëve të cilët ishin mbuluar me çarçaf dhe po hanin copa buke. Ai i përshëndeti ata dhe ata e ftuan në mesin e tyre për të ngrënë. Ai u ul dhe tha: "Nëse ky ushqim nuk do të ishte lëmoshë do të haja me ju". Pastaj i tha atyre: "Çohuni dhe ejani në shtëpinë time". Pastaj Imam Husejni i ushqeu ata, i veshmbathi dhe urdhëroi që t'iu jepnin atyre edhe dërhemë (të holla).

3. Transmetohet nga Shuajb ibn Abdurrahmani se: Në ditën e vrasjes së Husejnit në shpinën e tij u pamë njolla. Për këtë e pyetën Imam Zejnul-Abidinin, djalin e Imam Husejnit. Ai tha: **"Kjo është për shkak të trastave që mbante mbi shpinën e tij dhe i shpërndarë nëpër shtëpitë e të vejave, jetimëve dhe të mjerëve".**

Roli i tij në vazhdimësinë e Islamit

Në kohën kur vëllai i tij, Imam Hasani, qeveriste muslimanët me qendër në Kufe, Imam Husejni jetoi krah për krah tij, dhe iu bind atij në çdo situatë. Pas aktit të marrëveshjes dhe **"pajtimit"**, që të dy së bashku me anëtarët e tjerë të Ehli Bejtit shkuan në Medinë për të shpjeguar ligjet e fesë islame dhe për të mbrojtur Kuranin nga rrymat devijuese. Pas vdekjes së vëllait të tij, roli i Imam Husejnit hyri në një fazë të re.


Ai u ballafaqua me planet devijuese të emevitëve për shoqërinë muslimane. Emevitët në krye të tyre kishin Muaviun dhe djalin e tij Jezidin, kurse muslimanët kishin Imam Hasanin, por emevitët atë e vranë përmes helmimit. Marrëveshja dhe **"pajtimi"** si pikë kryesore kishte: **"Pas Muaviut, udhëheqjen duhet ta merrte Imam Hasani, e mbas tij Imam Husejni".** Por, Muaviu e kundërshtoi dhe e theu këtë atk të marrëveshjes dhe emëroi djalin e tij, Jezidin, në krye të muslimanëve, gjë që nënkuptonte kthimin në kohën e injorancës para se të shpallej Kurani.

Vdekja e tij

Sa ishte gjallë dhe pas vdekjes së Muaviut, filloi sistemi diktatorial dhe tiran, meqë ky e caktoi djalin e tij Jezidit në krye të shtetit. Me të marrë

Husejnit

(paqja qoftë mbi të)




pushtetin Jezidi, urdhëroi në përgjithësi njerëzit t'ia jepnin besën për besnikëri dhe Imam Husejni në veçanti. Imam Husejni besën nuk ia dha askujt, sepse shumë muslimanë që gjendeshin në Kufe (të Irakut të sotshëm) pritnin që atij t'ia jepnin besën dhe për këtë i kishin shkruar me dhjeta letra mbështetëse për të dhe kundërshtuese për qeverisjen e Jezidit. Pasi Imam Husejni pranoi këto letra mbështetëse, u nis me mbi shtatëdhjetë familjarë të tij nga Meka në drejtim të Irakut. Ai u ndalua në tokën e quajtur Kerbela (Qerbela) me rreth pesëmijë ushtarë të Jezidit. Kjo tokë ishte shkretëtirë, pa ujë dhe pa gjelbërim.

Në këtë vend arriti më datë 2 Muharem të vitit 61 pas Emigrimit ose 2 tetor 680. Pas një ultimatumi 10-ditor që Imam Husejnit iu caktua që t'ia jepte besën diktatorit zullumqar Jezidit, Imam Husejni nuk pranoi, por pranoi që të shkonte dëshmor së bashku me mbi shtatëdhjetë familjarë të tij më datën 10 Muharrem të vitit 61, ose 10 tetor 680. Kjo ditë quhet "e dhjeta" apo arabisht: āshūrā.

Poeti ynë kombëtar dhe rilindas, Naim Frashëri (1846-1900) ia kushtoi poemën epike-fetare me njëzetepesë këngë "Qerbelaja", vepër kushtuar veprës dhe trimërisë së Imam Husejnit në fushën e Qerbelasë.

Urime ditëlindja e Imamit
të tretë të Ehli Bejtit,
Hazret Imam Husejnit!



Arsimimi tek arabët *para Islamit*

Në mesin e arabëve kishte shumë pak individë që mund të shkruanin dhe të lexonin. Shumë prej tyre nuk ishin të interesuar për ta mësuar këtë art. Një pjesë e historianëve janë të mendimit se kultura e kësaj periudhe ishte e themeluar krejtësisht në përcjelljen gojore. Hebrenjtë dhe të krishterët ishin flamurtarët e shkrim-leximit në Arabi, ndërkohë që arritja më e madhe intelektuale e arabëve paganë ishte poezia e tyre.

Ata besonin se Zoti ua kishte dhënë aftësinë e të menduarit grekëve (shkencën dhe filozofinë), aftësinë e punëve të dorës kinezëve (me zejtarinë e tyre të përsosur) dhe arabëve aftësinë e gjuhës (me gojëtarinë e tyre). Krenaria e tyre më e madhe, para dhe pas Islamit, ishte përherë gojëtaria (oratoria) dhe poezia. Rëndësia e poezisë në shoqërinë arabe mund të lexohet nga veprat vijuese të historianëve:



David Samuel Margoliouth:

"Në Arabinë nomade, poetët ishin pjesë e pajisjes ushtarake të fiseve. Ata i mbronin forcat e fisit të tyre dhe i dëmtonin fiset armike me një fuqi, e cila vepronte në mënyrë misterioze dhe përbëhej nga përpilimi i vargjeve interesante që do të tërhiqnin vëmendje dhe do të mbaheshin mend gjatë"

('Muhammedi dhe rritja e Islamit', botuar 1931).

Evgenie Aleksandroviç Beljaev:

"Pjesa më e madhe e njohurive mbi gjendjen ekonomike, sociale dhe morale të Arabisë në shekullin e pestë dhe të gjashtë vjen nga poezia e lashtë dhe paraislamike e arabëve, e cila është e njohur për përshkrimin besnik të periudhës në të cilën u përpilua, të jetës fisnore të arabëve dhe të mjedisit ku jetonin. Andaj specialistët i pranojnë këto poezi si burimet më të rëndësishme dhe autoritative për t'i përshkruar arabët dhe traditat e tyre në këtë periudhë"

('Arabët, Islami dhe Kalifati arab në mesjetë', botuar 1969)".

Poezia arabe ishte e pasur për nga shprehja dhe rrjedhshmëria mirëpo ishte shumë sipërfaqësore dhe i mungonte thellësia e duhur në kuptim. Përmbajtja e saj mbase ishte interesante por ishte

shumë e zakonshme dhe e mbushur me klishé. Thuajse të gjitha kryeveprat e poezisë së tyre e ndjekin të njëjtën rrjedhë të ideve dhe figurave. Por sido që të jetë, ajo ishte një pasqyrë shumë besnike e jetës në Arabinë pagane. Përveç kësaj, poetët arabë në një mënyrë të pavetëdijshme e zhvilluan njërin nga artifaktet më të mëdha të njerëzimit: gjuhën arabe.

Përmbledhja me krijimet më të rëndësishme poetike të Arabisë pagane njihej si "Odet e Arta". Kjo ishte një përmbledhje prej shtatë poezish që konsideroheshin të pakalueshme për nga rrjedhshmëria dhe fuqia gjuhësore. Këto poezi rrinin varur në Qabe si një sfidë që duhet ta përballonin poetët e rinj. Sir William Muir, në lidhje me këto poezi shkruan:

"Shtatë Poezitë e Varura' kanë mbijetuar nga një periudhë që daton para Muhammedit, si shembuj të një gojëtarie të pashoqe. Bukuria gjuhësore dhe pasuria e egër figurative pranohen nga lexuesi evropian, por shumë shpesh, subjekti i poetit është i kufizuar dhe shumë rrallë devijon nga kallëpet e krijuara. Bukuria e të dashurës së tij, vendi i dëshiruar me gjurmët e freskëta të qëndrimit të tij në të, vetmia e një vendi të shkretuar, bujaria dhe aftësia e vetë poetit, lavdia e pakontestueshme e fisit të tij, cilësitë fisnike të devesë së tij dhe tema të tjera të ngjashme përpunoheshin me variacione të vogla, pa dallim se ç'ishte tregimi që fshihej pas një poezie. Shumë prej këtyre veprave veç me tepër e shtonin ligësinë e njerëzve, vetëpëlqimin e tyre, xhelozinë, mizorinë dhe krenarinë" ('Jeta e Muhammedit', botuar 1877)".

Me zhvillimin e Islamit, vëmendja u kthye më tepër drejt prozës dhe poezia e humbi pozitën e saj si mbretëresha e arteve në Arabi.

"Vepra" më e madhe e Islamit ishte Kur'ani, Shkrimi i shenjtë i kësaj feje, ishte në formë të prozës. Myslimanët besojnë se Kur'ani u krijua në Qiej përpara se t'i shpallej Muhammedit, të Dërguarit të Zotit. Ata besojnë se intelekti njerëzor nuk mund të krijojë diçka që mund të matet me të për nga stili dhe përmbajtja. Për pesëdhjetë brezat pararendës, ai ka qenë një model i mendimit letrar, filozofik, teologjik, ligjor, metafizik dhe mistik.

Në faqet paraprake u përpoqëm të bënim një portretizim të përgjithshëm të gjendjes së Arabisë dhe të jetës së banorëve të saj para Islamit. Ky "portret" është autentik dhe është marrë nga "arkivat" e vetë arabëve paraislamikë. Duke gjykuar sipas këtij përshkrimi, mund të thuhet se para Islamit, Arabia nuk kishte një rend shoqëror dhe një rëndësi historike. Arabët jetonin me një moral të degraduar dhe të robëruar shpirtërisht. Jeta e tyre ishte e pakuptimtë, pa ndonjë arsye dhe pa qëllim. Shpirti njerëzor ishte i prangosur dhe po priste një shenjë për të filluar një përpjekje titanike për t'u shpëtuar zinxhirëve dhe çliruar.

Kjo shenjë u dha në qytetin e Mekkes në vitin 610 nga Muhammedi, i biri i Abdullahut, kur ai e shpalli profetësinë e tij dhe e filloi historinë e lëvizjes së quajtur "Islam", e cila do ta mbështillte gjithë botën. Për njerëzimin ky ishte bekimi më i madh, i cili i çliroi nga robëria burrat dhe gratë, duke i mësuar t'i bindeshin Krijuesit të tyre. Muhammedi, i Dërguari i Zotit, ishte emancipuesi suprem i njerëzimit, i cili e nxori njerëzimin nga "greminat e jetës".

Gadishulli Arabik ishte një vend gjeografikisht periferik dhe politikisht një terra incognita [lat. tokë e panjohur] deri në shekullin e shtatë pas Krishtit. Pikërisht atëherë, Muhammedi e vendosi këtë vend në hartën politike të botës, duke e bërë atë teatrin e disa prej ngjarjeve më të rëndësishme të historisë.

Para Islamit, arabët kishin luajtur një rol krejtësisht margjinal në historinë e Lindjes së Mesme dhe mbase do të kishin mbetur përgjithmonë një popull barinjsh sikur Muhammedi (bekimi i Zotit qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij) të mos ua jepte atë stimul që i ktheu fiset e tyre nomade në një forcë që kishte qëllime. Ai krijoi një "komb" nga një masë njerëzish pa kurrfarë strukture shoqërore. Ai i pajisi arabët me një dinamizëm të ri, me idealizëm dhe me një kreativitet eksploziv, me të cilin ata e ndryshuan përgjithmonë rrjedhën e historisë. Ai krijoi një gjendje të re mendore dhe psikologjike tek arabët. Veprimtaria e tij ishte një periudhë kritike e historisë, ku mbaroi një epokë dhe filloi një tjetër.

Duke folur për ndikimin e tij të madh në histori, Francesco Gabrieli, në librin e tij "Arabët- një histori e përmbledhur" (botuar 1963), thotë:

"...Me këtë mbaroi preludi pagan i historisë së arabëve. Nuk mund të mos e vërejë ndryshimin e fatit të këtij populli gjithsecili që e krahason këtë periudhë pagane me atë që vijoi dhe që u solli arabëve një rol primar në historinë e botës dhe frymëzoi vepra e mendime të mëdha, jo vetëm tek një njeri i jashtëzakonshëm nga mesi i tyre por tek një elitë e tërë, e cila brez pas brezi i përmblodhi dhe i përhapi fjalët e tija. Ritmi i kësaj shoqërie që deri atëherë ishte e dobët dhe e shpërndarë, u kthye në një kërkim uniteti, kërkim të një qendre

dhe të një qëllimi, të cilin do ta gjenin nën flamurin e besimit. As dashuria më romantike për gjërat primitive nuk na lejon të mos e shohim faktin se pa Muhammedin dhe pa Islamin, ky popull do të mbetej përgjithmonë duke u endur nëpër shkretëtirë, duke e shkatërruar njëri-tjetrin në luftëra të përgjakshme ndërfisnore dhe duke i parë Bizantin, Ktesifonin dhe madje Aksumin si rreze të largëta të civilizimit, të cilat qëndronin shumë përtej aftësive të tyre".

Marrë nga libri "Ritregim i historisë së Islamit dhe myslimanëve", autor: Sejjid Ali Asghar Razvi, përktheu: Numan Mustafa, shtëpia botuese: "Dielli", Prishtinë, qershor 2013, fq. 52-55.





Pajtimi dhe dashamirësia

"Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata. Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e Allahut. E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi. Bëni drejtësi sepse, Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi".

Huxharta Huxhurat 9-10

"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni".

Shkaqet e zbritjes

Rreth shkakut të zbritjes së këtyre dy ajeteve thuhet se: në mesin e dy fiseve të njohura në Medine El-Eus dhe Khazrexh ndodhi një konflikt i cili i çoi në grindje me njëri-tjetrin. Atëherë zbritën dy ajetet e lartpërmendura duke u mësuar muslimanëve mënyrat e përballjes në të tilla ngjarje apo konflikte. Disa të tjerë thonë se: Në mes dy personave prej ensarëve ndodhi një konflikt. Njëri prej atyre dyve i tha tjetrit: "Unë do të marr të drejtën time nga ti me forcë, sepse fisi im është më i shumtë. Tjetri tha: Të shkojmë tek i Dërguari i Allahut për të na gjykuar. Ai i pari nuk pranoi. Atëherë konflikti u ashpërsua edhe më tepër derisa të dy fiset u grindën me njëri – tjetrin me shkopinj me këpucë deri dhe me shpata. Për këtë zbritën këto dy ajete duke sqaruar detyrën e muslimanëve për këto situata.

Komentimi:

"Besimtarët janë vëllezër"

Në këto ajete kur'anore duket qartë një ligj që është përgjithësues dhe i përshtatshëm për çdo kohë dhe vend **"Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata..."** e ky ligj është pajtimi.

Është e saktë se fjala "iktetelu" rrjedh nga fjala "kital", (luftë), por siç dëshmojnë edhe faktet ajo përfshin të gjitha llojet e konflikteve edhe pse nuk arrijnë në fazën e përballjes me armë. Këtë kuptim e sqarojnë edhe transmetimet rreth shkakut të zbritjes së ajetit.

Por mund të thuhet se: Nëse gjenden shkaqe për konflikt, siç janë grindjet me fjalë, të cilat arrijnë në konflikte gjakderdhëse, atëherë, sipas ajetit në fjalë, duhet të bëhen përpjekje për pajtim mes pjesmarrësve në konflikt, sepse në bazë të kuptimit të ajetit, përpjekjet për pajtim mund të jenë parandaluese të armiqësisë dhe urejtjes. Prandaj është detyrë e të gjithë muslimanëve që të bëjnë pajtim në mes personave apo grupeve që janë në konflikt me njëri-tjetrin, me qëllim që të mos ndodhin gjakderdhje. Po ashtu, duhet t'i njohin përgjegjësitë e tyre në këtë drejtim dhe të mos qëndrojnë duarlidhur si spektatorë, njëlloj si disa të paditur të cilët i kalojnë këto çështje pa u kushtuar asnjë lloj rëndësie e interesimi! Kjo është detyra e parë e besimtarit përballë këtyre çështjeve.



Më poshtë Kur'ani sqaron detyrën e dytë ku thotë: "Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën..." dhe nuk i dorëzohet propozimit të pajtimit "atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e Allahut". Është e natyrshme se nëse do të vritet grupi kundërshtues, mëkatin e kanë mbi veten e tyre, ose siç thuhet gjaku i tyre është hedr (i lejuar për t'u derdhur), edhe nëse janë muslimanë, sepse konflikti ka ndodhur në mes dy grupeve besimtarësh.

Islami e ndalon padrejtësinë edhe nëse çështja arrin në luftimin e të padrejtit, sepse vlera e drejtësisë është më e shtrenjtë se gjaku, qofshin edhe muslimanë. Por, lufta nuk realizohet, vetëm kur dështojnë zgjedhjet paqësore.

Pastaj Kur'ani paraqet detyrën e tretë ku thuhet: **"E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi".** Pra, muslimanët nuk duhet të kenë bindjen e zhdukjes me forcë të grupit kundërshtues e të padrejtë, por duhet të bëjnë pajtim, i cili është parapritë për shkuljen nga rrënjët të shkaqeve të konfliktit, sepse me kalimin e kohës i padrejti i rikthen fuqitë dhe ngrihet për së dyti në konflikt. Edhe pse ka raste që mund të ndodhin çrregullime në gjykata apo në gjykime mes grupeve në konflikt, këto çrregullime e kanë burimin tek devijimi i gjykatësve.

Kur'ani u paraqet muslimanëve detyrën e katërt: **"Bëni drejtësi sepse, Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi".** Ajeti i mëposhtëm, duke vërtetuar shkakun dhe vërtetësinë e kësaj çështjeje thotë thotë: **"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre..."** Pra, ashtu siç përpiqeni të bëni pajtim në mes vëllezërve në gjenezë (prej një nëne e babai), duhet të përpiqeni sinqerisht për të bërë pajtim në mes vëllezërve në fe që kanë rënë në konflikt, e këtë ta bëni me drejtësi të plotë.

Çfarë përsosurie dhe ç'retorikë hasim në ajetin kur'anor kur besimtarët i quan **"vëllezër"** dhe konfliktin mes tyre e konsideron konflikt mes vëllezërish! Me anë të këtij ajeti, Kur'ani kërkon që pajtimi dhe dashamirësia të sundojnë në jetën e besimtarëve.

Në fund Kur'ani thotë **"...dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni".** Në këtë mënyrë sqarohet një prej përgjegjësive të rëndësishme shoqërore tek muslimanët, e cila është domonimi i drejtësisë shoqërore me të gjitha dimensionet e saj në të gjitha fushat e jetës së tyre.

Shpirtmadhësia dhe fisnikëria

Murteza Mutahhari

"Kthehu te Zoti yt i vetëkënaqur e i pranuar!
Hyn në mesin e robërve të Mi! Dhe hyn në Xhennetin Tim!"
(Kurani Famëlartë, surja el-Fexhr, 89: 28-30).

Nëse dikush arrin të ketë shpirt të madh, do apo nuk do, trupi i tij do të jetë në vuajtje e mundime. Vetëm ai trup që posedon shpirt të vogël, kënaqet duke jetuar në komoditet, madje edhe mund të jetojë gjatë, kënaqet duke fjetur e duke ngrënë ushqime të këndshme, po ai që ka shpirtmadhësi, ai shpirt i tij i madh i shkakton trupit vuajtje, madje, ndonjëherë edhe jetë të shkurtër. Ai trupit i shkakton sëmundje. Do të flasim diçka për madhështinë dhe fisnikërinë e shpirtit dhe do të shpjegojmë dallimin mes këtyre dy gjërave, sepse madhështia e shpirtit është diçka tjetër, ndërsa fisnikëria e shpirtit është gjëja tjetër më e përsosur. Pra, secila madhësi shpirti nuk është fisnikëri.
Ç
do fisnikëri është shpirtmadhësi, e çdo shpirtmadhësi nuk është fisnikëri. Me siguri, ambiciet e mëdha janë shenjë e shpirtit të madh, ndërsa ambiciet e vogla janë shenjë e shpirtit të vogël.

"Kij ambicje të mëdha sikur njerëzit e mëdhenj, për shkak të ambicieve të mëdha kanë arritur gjer diku!"


Një poet tjetër, thotë:

"Bilbili në kopsht e laraska në gërmadha,
secili sipas sasisë së ambicieve të veta,
shtëpi ka ndërtuar".

Kjo mund të aplikohet në cilindo profesion të njeriut. Për shembull, ambiciet në shkencë dallojnë. Dikush është i kënaqur me diplomën e shkollës së mesme dhe të ketë një profesion gjer në atë nivel sa që të dijë të shkruajë e të lexojë, e personi tjetër e shihni, me plot arsye, se nuk është i kënaqur me asnjë nivel shkencor, ai ka ambicie që gjer në momentin e fundit të jetës së tij të mos lëshojë mundësinë për të arritur njohuri shkencore dhe zbulime të të vërtetave shkencore.



Me siguri keni dëgjuar për tregimin e Ebu Rejhan el-Birunit. Ky është një njeri për të cilin studiuesit pohojnë se ende nuk i është gjetur rivali atij. Ka qenë shkencëtar, matematikan, sociolog, historian dhe njeri i dalluar, ndërsa dikush e konsideron si më të mirë se Ibën Sinai. Natyrisht, nëse i marrim parasysh disa segmente dhe lëmenj, me siguri se Ebu Rejhani ka qenë më i mirë se Ibën Sinai. Këta të dy kanë qenë bashkëkohanikë. Ai ka qenë i fascinuar me shkencën, me kërkimet dhe zbulimet e reja.



Një herë e thirri mbreti Muhammed dhe ky iu përgjigj thirrjes së tij dhe shkoi te ai, por si çdo njeri ambicioz, e shfrytëzoi rastin. Kur mbreti Muhammed e pushtoi Indinë, edhe ky shkoi me të në Indi. E kuptoi se e ka zbuluar një pasuri informacionesh shkencore, por s'e njihte sanskritishten. Këtë gjuhë shumë mirë e mësoi në pleqëri. Atje disa vite me radhë u muar me hulumtime. Shkroi një vepër të titulluar: "Hulumtimet në Indi..." Sot ky libër konsidero-

het si një prej burimeve kryesore për indologët e botës.


Kur ky njeri ishte në prag të vdekjes, një fekih (jurist islam) që ishte fqinj i tij, mori vesh se Ebu Rejhani ishte në atë gjendje, shkoi ta vizitojë. Ai ende nuk e kishte humbur vetëdijen. Me të parë fekihun, i parashtroi pyetje në lidhje me ngrirjen (nga të ftohtit) ose për diçka tjetër.[1] Fekihu u habit dhe i murmuriti: **"Ti po përgatitesh për të vdekur, dhe ke gjetur kohë të më parashtrosh këso pyetjesh!?"** Ebu Rejhani u përgjigj: **"Ty po të parashtroj një pyetje. Nëse unë vdes, (nuk e dij se a do të vdes tash shpejt) a është më mirë të dijë apo të vdes duke mos ditur?"** Fekihu u përgjigj: **"Paj, natyrisht, se më mirë është të dish".** Ai ia ktheu: **"Mu për atë shkak të pyes".** Fekihu tregoi se posa doli nga shtëpia e tij, nuk shkoi shumë kohë, dëgjoi një piskamë dhe vaj. Vdiq Ebu Rejhani dhe u dëgjuan të qarat e fëmijëve të tij. Thanë për këtë se ka qenë një njeri i madh me ambicie të mëdha për shkencë.

Tjetri, për shembull, është i madh që vepron për fitimin e pasurisë. Po a thua vallë, ambiciet janë të njëjta edhe në aspekt të grumbullimit të pasurisë? Disa njerëz, natyrisht, nuk kanë asnjë ambicie për grumbullim të pasurisë dhe qëllimi i tyre është të jenë të ngopur, të kenë ndonjë kore buke, po edhe sikur atë ta arrinte përmes shërbimit, nënshtrimit ose lypjes. Por, dikush dëshiron të ketë, dëshiron të tubojë para. Tani, a janë të barabartë ata që dëshirojnë të tubojnë pasuri me të tjerët? Apsolutisht jo. Te disa njerëz, nga vetë natyra, ekziston dëshira për grumbullim të pasurisë dhe nuk kënaqen me pak. Po e them këtë, se ndonjëherë disa njerëz që s'kanë ambicie, nga shkaku se nuk janë njerëzorë, kur e shohin dikë se si grumbullon pasuri, e nënçmojnë dhe e përqeshin, sikur vetë ata na qenkan të devotshëm. Ai që mundohet të tubojë pasuri me një vullnet të tillë, është më i mirë se dikush që ka ambicie të dobëta dhe karakter lypësi, dhe është personalitet se ai. Ky, në krahasim me atë njeri që ka më shumë ambicie, meriton të qortohet. Një zahid (asket) i vërtetë mund ta qortojë atëherë kur të bëhet njeri ambicioz, sikur Imam Aliu a.s. që është njeri punëtor dhe që mundohet për pasuri, por nuk është lakmues, nuk e ruan për vete, nuk është i lidhur ngushtë për ato para. Fiton, por përse? Për shpenzim dhe për të ndihmuar të tjerët. Ai ka të drejtë të qortojë dhe të thotë:

"I mjeri ti, o lakmues, që ke ambicie, vendosmëri, ti që ke entuziazëm dhe fuqi, pse harxhon fuqinë tënde për grumbullim të pasurisë? Pse pasuria të është bërë qëllim? Për ty pasuria duhet të jetë mjet".

Por unë që nuk kam ambicie, ndërkaq pasurinë e marr duke lypur nga të tjerët të cilëve ua puthi duart e këmbët që të më japin një të mijëtën apo një të miliontën pjesë të pasurisë së vet, nuk kam të drejtë ta kritikoj. Tjetri person ec rrugës së ambicieve, madhësisë dhe pozitës. Po a janë gjithë njerëzit në këtë drejtim të barabartë?

Huazuar nga libri: "Rrëfime shpirtërore", autor: Murteza Mutahhari, përktheu: prof. Mahir Hasani, botues: "Shoqata Flladi", Tiranë 2004, fq. 114-117.



[1] Duke u bazuar në veprat që kanë shkruar studiuesit mbi biografinë e Ebu Rejhanit, tregohet se ka qenë një besimtar shumë i fortë, musliman me besim të fortë. Në librat e tij të cilat, nuk kanë të bëjnë me shkencat fetare, siç është "El-'Asrul-Bakij" dhe të ngjashëm, sikur edhe Ibën Sinai, kudo që të përmendej Islami, Kur'ani dhe Sheriati, ai jep ashtu mendim të devotshëm, me përulje dhe me besim, saqë njeriu nuk mund të dyshojë në qëllimet e tij të pastërta.


Thënie motivuese nga Naim Frashëri

Një komb ç'vlerë i vënë vetës, atë vlerë i vënë edhe të haujt.

Njeriu vlenë aq sa i vlen puna që bën.

Ai që ka e si jep të varfërit, është si një dru që as lule nuk lëshon, as hije nuk bëne e as pemë nuk jep.

Kali atë të ecur që e mëson në vegjëli e ka gjerë të plaket.



Mësoni fëmijët tuaj të dinë më shumë se ju, se ata janë për një kohë më tej nga koha juaj.

Një mijë fjalë të mira, të nënës e të babait, nuk vlejnë për fëmijën sa vlenë një punë e mirë që e shohin me syt e tyre.

Ska në jetë njëri më të ligë se tradhëtari i kombit dhe i mëmëdheut.

Njeriu i mirë mbahet mend gjithnjë për të mirë, i ligu për të ligë.

Koha s'vjen pas teje, ti hiq pas kohe.

Atë që sdo të ta bëjnë ty të tjerët, mos ua bëj dhe ti atyre.

Të mos themi kurrë Muslimanë e të Krishterë, Ortodoks e Katolik, por vetëm Shqiptar, të bashkuar e të pandarë.

Gruaja është nënë e fëmijës, zonjë e shtëpisë dhe koka e njerëzisë.

Pa punuar njeriu nuk trashëgon asgjë, pa lëvruar e pa mbjellë nuk korr dot.

Njeriu i paditur është dru i pagdhendur.

Punë, punë natë e ditë, që të shohim pakëz dritë.

Nuk më ngjan e se besoj, kam te Zoti shumë shpresë, Shqipëria këtej e tutje kështu më nuk do të mbes.

Rruga jonë është me gjemba, por qëllimi ynë është aq i lartë sa ia vlenë të ecësh mbi gjëmba.

Mësoni dituritë e gjithësisë, atëherë do të kuptoni kuptoni Zotin e madh e të vërtetë.

Njihe vetvetën, se gjithë ç'ka gjithësija është te njeriu.

Lutje për mirëseardhjen e Muajit Ramazan
nga Imam Zejnul-Abidini (a.s.)



- Falënderimi e lavdërimi është vetëm për Allahun i Cili na udhëzoi të falënderojmë Atë, që na bëri prej atyre që besojnë në fenë e Tij, që me bamirësinë e Tij bëri të jemi falënderues dhe që për këtë Ai të na japë shpërblimin e bamirësve.

- Falënderimi e lavdërimi është vetëm për Allahun, i Cili na ka dhuruar fenë e Tij e na ka veçuar me udhëzimin për në fenë e Tij. Me mirësinë e Tij ka bërë që të ecim në rrugët e Tij, me mirësinë e Tij ka bërë që të ecim nëpër këto rrugë për të arritur kënaqësinë e Tij, falënderim e lavdërim që Ai ta pranojë prej nesh dhe të jetë i kënaqur me punën tonë.

Falënderimi e lavdërimi është vetëm për Allahun, i Cili ndër këto rrugë ka bërë muajin e Tij, muajin e Ramazanit, muajin e agjërimit, muajin e Islamit, muajin e pastrimit, muajin e sprovës, muajin e faljes namaz **"... në të cilin u zbrit Kurani udhëzues për njerëzit, shpjegues i rrugës së drejtë dhe dallues i së vërtetës prej të gabuarës".**

- Për këtë shkak e ka dalluar mirësinë e këtij muaji mbi të gjithë muajt e tjerë, për gjërat e shenjta e të plotësuara që Ai ka vënë në këtë muaj e për gjitha mirësitë e dukshme e të njohura. Për të madhëruar këtë muaj Ai ka ndaluar rreptësishtë punë e veprime që i ka lejuar në muajt e tjerë, në këtë muaj Ai ka ndaluar ngrënien e pijen, për këtë muaj Ai ka bërë një kohë të shpjeguar qartë dhe i Lartësuari nuk ka lejuar që kjo kohë të përshpejtohet ose të shtyhet.

- Një natë të vetme të këtij muaji Ai e ka bërë më të vlerësuar se netët e njëmijë muajve, Ai e ka emëruar këtë natë "Nata e Kadrit" "Me lejen e Zotit të tyre në këtë natë engjëjt edhe shpirti për secilën punë zbresin shpëtim...", vazhdimisht me begati deri në agim për të cilin të dëshirojë Ai prej robërve të Tij e me atë që Ai ka caktuar në vendimin e Tij.
O Zoti im, dhuro paqe dhe shpëtim për Muhammedin e për familjen e tij, na inspiro dituri për mirësinë e këtij muaji e për madhështinë e shenjtërisë së tij, na inspiro kujdes në veprimet që Ti i ke ndaluar në këtë muaj, na ndihmo të agjërojmë në këtë muaj e të ndalojmë gjymtyrët tona nga kundërshtimi i urdhërit Tënd, na ndihmo që ne t'i përdorim gjymtyrët tona vetëm në punët me të cilat arrihet kënaqësia Jote, bëj që veshët tonë të mos dëgjojnë fjalë boshe e që sytë tonë të mos e hedhin shikimin tonë në gjërat që nuk na interesojnë.

Bëj që ne të mos e zgjasim dorën në gjëra të ndaluara, që me këmbët tona të mos shkojmë në vende të ndaluara, ruaji barqet tona që ato të mos kenë gjë tjetër përveç gjërave që Ti ke lejuar, që gjuhët tona të mos thonë fjalë tjetër përveç shembujve që Ti ke sjellë, që ne të obligohemi vetëm me ato punë të cilat na afrojnë në shpërblimin Tënd, që të merremi vetëm me ato punë të cilat na ruajnë prej dënimit Tënd. O i Madhëruar, na shpëto prej hipokrizisë së hipokritëve e nga puna që të na shohin të tjerët, bëj që në këtë muaj të mos adhurojmë asnjë tjetër përveç Teje.

O Zoti im, dhuro paqe dhe shpëtim për Muhammedin e për familjen e tij, në këtë muaj bëj që të pesë namazet t'i falim në kohët që Ti i ke caktuar, të plotësojmë farzet e namazeve që Ti i ke bërë të detyrueshme, t'i kryejmë namazet sipas të gjitha rregullave që Ti ke vënë e në kohët që Ti ke përcaktuar.

Bëj që ne të respektojmë e të nderojmë këtë muaj, të ruajmë të gjitha rregullat e adhurimit, të kryejmë adhurimet në kohën e vet, ashtu siç ka bërë robi e i Dërguari Yt (paqja e shpëtimi Yt qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij) në rukunë e në sexhdenë e namazit e në të gjitha farzet e tjera, të gjitha këto t'i kryejmë me pastrimin e kërkuar e në mënyrën më të mirë dhe bëje të dukshëm e të fortë nënshtrimin tonë.

Në këtë muaj bëje mbarë që ne të mbajmë lidhjet me të afërmit me mirësi e me vajtje ardhje, me fqinjët tonë të përtërijmë mirësjelljen e dhëniet, të shpëtojmë pasuritë tona prej fatkeqësive e t'i pastrojmë ato me dhënien e zeqatit, të shkojmë te ai që nuk na vjen, të falim atë që na ka bërë padrejtësi, të pajtohemi me atë që është armiqësuar me ne, me përjashtim të atij me të cilin duhet treguar armiqësi për hirin Tënd e për kënaqësinë Tënde sepse ai është armiku që ne nuk e duam për mik, është grupi prej të cilit kemi detyrë të ruhemi.
Në këtë muaj bëj që të afrohemi te Ti me punë të pastra, me të cilat Ti na pastron prej gjynaheve, në këtë muaj na ruaj nga rifillimi i punëve të urryera, derisa asnjëri prej engjëjve Tuaj të mos vijë te Ti pa dëshmuar për ne që jemi në rrugët e bindjes ndaj Teje dhe se të gjitha llojet e adhurimeve i kemi bërë për t'u afruar te Ti.

O Zoti im, të lutem me të vërtetën e këtij muaji, me të drejtën e atij që kryen adhurim për Ty në këtë muaj qysh prej fillimit të tij e deri sa ai të mbarojë, qoftë ky adhurues melek i afërm te Ti, ose profet i dërguar nga ana Jote, ose njeri i mirë të cilin Ti e ke përveçuar, të dhurosh paqe e shpëtim për Muhammedin e për familjen e tij. Në këtë muaj na bëj të denjë për premtimet që Ti ke bërë për miqtë Tuaj, në këtë muaj siguro për ne gjërat që ke siguruar për më të përkushtuarin në bindjen ndaj Teje dhe me mëshirën Tënde na rradhit në grupin e më të nderuarve.

O Zoti tim, dhuro paqe dhe shpëtim për Muhammedin e për familjen e tij, na largo prej animit nga e vërteta e Njëtimit për Ty, nga pakësimi i lavdërimit për Ty, nga dyshimi për fenë Tënde, nga verbëria prej udhës Tënde, nga shkujdesja prej gjërave që Ti ke ndaluar dhe nga mashtrimi i armikut Tënd shejtanit të përzënë.

O Zoti im, dhuro paqe dhe shpëtim për Muhammedin e për familjen e tij, nëse me faljen Tënde në çdo njërën prej netëve të këtij muaji, do të shpëtosh një person nga dënimi ose për atë do të dhurosh mosqortim atëherë na bëj edhe ne prej atyre personave dhe në këtë muajin tonë, na bëj prej njerëzve e prej shokëve më të mirë.

O Zoti im, dhuro paqe dhe shpëtim për Muhammedin e për familjen e tij, shlyeji gjynahet tona me mbarimin e hënës së këtij muaji, hiqi prej nesh detyrimet e mbetura së bashku me mbarimin e ditëve të këtij muaji, derisa ato të jenë të shlyera për ne. Në këtë muaj Ti i ke fshirë të gjitha fajet tona dhe në këtë muaj Ti na ke shpëtuar prej të gjitha gabimeve.

O Zoti im, dhuro paqe dhe shpëtim për Muhammedin e për familjen e tij, nëse në këtë muaj ne biem në gjynahe Ti vendos drejtësinë për ne, nëse në këtë muaj ne largohemi nga rruga e drejtë Ti na drejto dhe nëse na ka mbërthyer armiku Yt shejtani, na shpëto prej tij.

O Zoti im, mbushe këtë muaj me adhurimin tonë vetëm për Ty, zbukuroi kohët e këtij muaji me bindjen tonë ndaj Teje. Në ditët e këtij muaji na ndihmo të agjërojmë, në netët e këtij muaji na ndihmo të falim namaz të nënshtruar ndaj Teje, të përkushtuar vetëm për Ty, derisa dita e këtij muaji të mos dëshmojë kundër nesh për shkujdesje e as nata e këtij muaji për mangësi.
O Zoti im, na bëj të atillë në të gjitha muajt e në të gjithë ditët derisa të jemi në këtë jetë, na bëj prej robërve Tuaj të mirë "Të cilët trashëgojnë Firdeusin dhe aty janë përgjithmonë", "Të cilët japin prej asaj që u është dhënë dhe zemrat e tyre janë të frikësuara ngaqë e dinë se do të kthehen te Zoti i tyre" dhe janë prej atyre që "... nxitojnë për punët e mira dhe në ato garojnë".

O Zoti im, dhuro paqe dhe shpëtim për Muhammedin e për familjen e tij në çdo orë, në të gjitha kohët e në të gjitha gjendjet në atë numër që Ti ke dhuruar paqe e shpëtim për të gjithë të tjerët, madje dhuro shumëfishin e gjithë kësaj që vetëm Ti e numëron e askush tjetër, sepse vetëm Ti je Vepruesi sipas vullnetit Tënd.

Lutje e shpëputur nga libri me lutje "Sahife Sexhadije", autor: Imam Zejnul-Abidini, përkthyes: Haxhi Selim Stafa, botues "Shoqata Flladi", Tiranë 2008, fq. 316-327.



Ditëlindja e Imam Zejnul-Abidinit

paqja qoftë mbi të

Në ditën e pestë të muajit Sha'ban të vitit 38 pas Hixhretit/Emigrimit të Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) nga Meka në Medine, lindi Aliu nga nëna Hazreti Shehribane (Shahrbanu) dhe babai Hazreti Imam Husejni (paqja qoftë mbi ta). Aliu lindi në qytetin e Medinës. Nëna e tij ishte Shehribanja, vajza e mbretit të fundit të dinastisë Sasanide të Persisë, Jazdegerdit të tretë, ndërsa babai ishte Husejni, djali i Imam Aliut (paqja qoftë mbi ta).

Vepra dhe personaliteti i tij

Ali ibn Husejni u edukua në një ambient fetar dhe kjo ishte ndikuese në personalitetin e lartë të tij në fjalë dhe vepra. Sipas Imam Malikut: "Ai u quajt Zejnul-Abidin për shkak të adhurimeve të shumta që bënte". Ndërsa djali i tij, Hazret Muhamed Bakiri (paqja qoftë mbi të) për të thotë: "Sa herë që ai kujtonte mirësitë e Allahut binte në sexhde, dhe sa herë që lexonte ajetet e Kuranit binte në sexhde. Kur mbaronte namazet farze ai binte në sexhde, dhe sa herë që bënte pajtim në mes dy personave ai binte në sexhde". Sipas kësaj ai u quajt Imam Sexhad apo "ai që binte vazhdimisht në sexhde". Ai kishte pesëmbëdhjetë fëmijë, ndër më të dalluar në histori janë Hazret Muhamed Bakiri dhe Hazret Zejd bin Aliu.

Ky ishte ndër të vetmit që mbijetuan pas tragjedisë së Qerbelasë, sepse mrekullisht, në ato ditë ishte



shumë i sëmurë dhe nuk ndodhej në Qerbela, dhe pas vrasjes së babait të tij, Imam Husejnit, Hazret Ali ibn Husejni e mori vijueshmërinë e udhëheqësisë shpirtërore (Imametit), dhe ndër detyrat kryesore të tij ishin: ringjallja e përmendjes së Imam Husejnit, lutjet, marrja përsipër e problemeve dhe misioni mësimor.

Misioni i tij

Imam Zejnel-Abidini e mori përsipër ta vazhdojë misionit e babait të tij, Imam Husejnit. Në kohën e tij mbretëronte kaosi nga përndjekja dhe likuidimi i përkrahësve të Ehli Bejtit nga urdhrat mbretëror të Abdul-Melik ibn Mervan dhe Velid ibn Abdul-Melikut. Urdhrat e tyre i çonte në vend guvernatori i tyre, Haxhaxhi, i cili ishte një njeri i pamëshirshëm, xhelat, dhe historia e bën përgjegjës për vrasjen e disa dhjetra mijëra personave, kryesisht, ndjekës së mësimeve të Ehli Bejtit. Imam Zejnul-Abidini vazhdonte të ndiqte vijën e tij reformuese të bashkësisë së muslimanëve në fushën kulturore, udhëzuese, në urdhërimin në të mirë dhe ndalimin nga e keqja. Këto mësime nxisnin për mirësi dhe rigjallërim që njerëzit të ecnin duke mbajtur fenerin ndriçues me morale dhe udhëzime.

Kjo gjë i pengonte pushtetit dhe u urdhërua arrestimi dhe burgosja e tij, që ta frikësonte dhe ta detyronte që të hiqte dorë nga misioni i tij fetar. Dhe kështu ndodhi, që Imam Zejnel-Abidinin e helmuan. Ai ndërroi jetë më 25 Muharrem të vitit 95 pas Hixhretit, ose më 20 Tetor 713. Varri i tij gjendet në Medine, në varrezet "El-Bakij". Deri më 1925 varri i tij gjendej si një mauzole, por pushteti mbretëror saudit, e shkatërroi dhe sot është varr pa nishan.

Ndikimi i tij



Imam Zejnul-Abidini është imami i katërt me radhë i Ehli Bejtit. Ndikimi i tij tek masat e muslimanëve është shumë i theksuar. Sipas studiuesit të njohur William Chittick vepra me lutje e Imam Zejnul-Abidinit "Sahife Saxhadije": "Është libri më i vjetër i lutjeve sipas burimeve islame dhe një nga veprat më thelbësore të spiritualitetit islamik të periudhës së hershme". Përveç kësaj përmbledhjeje të lutjeve, Imamit i atribuohet edhe libri me pesëmbëdhjetë lutje përgjëruese me titull "Munaxhat".

Libri që përmban lutjet e Imam Zejnul-Abidinit "Sahife Sexhadije" dhe "Munaxhat" është përkthyer edhe në gjuhën shqipe në një vëllim, ka tekstin arabisht dhe shqip. Është i botuar në Tiranë më 2008 nga shoqata "Flladi", dhe ka 516 faqe.

Nga dy përmbledhjet e tij të lutjeve po i shkëpusim dy lutje përgjëruese, njëra është për moralet e larta, kurse tjetra për shpresën:

– "O Zoti im! Me mëshirën Tënde plotësoje qëllimin tim, me diturinë që është tek Ti saktësoje diturinë time dhe me fuqinë Tënde përmirësoje atë që është prishur në mua".

– "O Zoti im! Kush trokiti tek Ti të kërkojë heqjen e dhimbjes dhe Ti nuk ia hoqe; kush erdhi në portën Tënde duke shpresuar afrimin tek Ti dhe Ti nuk i dhe atij përparësi?! A është mirë që unë të sprapsem shpresëhumbur prej portës Tënde? Unë nuk njoh tjetër veç Teje të jetë cilësuar Mikbamirës?! Si të shpresoj në një tjetër veç Teje dhe gjithë e mira është në dorën Tënde?!"

Urime ditëlindja e Imamit të katërt të Ehli Bejtit, Hazret Imam Zejnul-Abidinit!

Toleranca ndërfetare ***te shqiptarët***



Besimi i njerëzve në një fuqi të mbinatyrshme që besohet se e ka krijuar këtë botë daton që nga fillimet e njerëzimit. “Feja ka një funksion shumë human dhe universal, ajo ka shumë vlerë për njeriun, se e bën më njerëzor, e bën më guximtar ndaj së ligës dhe i zbut plagët e shpirtit.” Mirëpo llojet e ndryshme të njerëzve kanë ndikuar në ndarjen e njerëzve ne fe te ndryshme dhe po këta njerëz me fe të ndryshme tani jetojnë në një hapësirë të përbashkët. Kështu rrjedhë çështja e tolerancës ndërfetare, të cilës ndër vite i janë referuar me terme të ndryshme. “Njohësit e mesjetës dhe etnologët përdorin termin “konvergjencë ndërfetare”. Sociologët dhe historianët sekularë priren nga termat “tolerancë”, “bashkëjetesë” apo “harmoni fetare”.” Populli shqiptarë me tri besime kryesore: islam, ortodoks dhe katolik, gjithmonë ka qenë simbol i tolerancës ndërfetare tek popujt e Ballkanit e ndoshta edhe më gjerë.

Larmia, ndryshueshmëria si dhe llojllojshmëria e njerëzve është një akt i qëllimshëm i Zotit për njohjen dhe afrimin e tyre mes vete, e jo për të treguar ose shprehur urrejtje ndaj njëri-tjetrit në baza racore fisnore apo edhe religjioze.
Në Kosovë në regjistrimin e fundit të popullsisë në vitin 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) nga 1,739,825 banorë në total, 1,663,412 i përkasin besimit islam; 25,837 prej tyre i përkasin besimit ortodoks; 38,438 i përkasin besimit katolik; 1,188 besojnë në një tjetër besim; 1,242 banorë nuk i përkasin asnjë feje.

Tradita e tolerancës ndërfetare tek shqiptarët nuk është diçka e formuar në kohët moderne, por një traditë që vjen nga thellësia e shekujve.



Faik Konica në shkrimet e tij për tolerancën fetare ndër shqiptar thoshte:

“Unë besoj se shqiptarët gjithkund janë tolerantë



“Feja ka një funksion shumë human dhe universal, ajo ka shumë vlerë për njeriun, se e bën më njerëzor, e bën më guximtar ndaj së ligës dhe i zbut plagët e shpirtit.”

për besimet e tjera dhe ndoshta ky është i vetmi vend në Evropë ku nuk ka pasur luftëra fetare”.

Një tjetër libër që flet për bashkëjetesën ndërmjet feve tek shqiptarët është **“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet?”** i shkruar nga **Sami Frashëri** ku thotë **“Shqipëtari është shqipëtar përpara se të jetë musliman a i krishtenë”**[1]. Ai në këtë kapitull po ashtu vazhdon duke thënë “Me gjithë ndryshimt të besëvet nukë janë të ndaar’ e të çarë po të bashkuar; kanë dashurinë në mes të tyre.”[2]

Për tolerancën ndërfetare janë shkruar disa libra siç është **"Prijës Fetarë dhe Shpirtëror Shqiptarë - Bashkëjetesa Ndërfetare dhe kontributi i tyre Kombëtar"** i autorit Faton Mehmetaj. Në këtë libër ai përmbledh figurat më të shquara shqiptare, dhe flet për tolerancën ndërfetare si një vlerë unike e popullit shqiptarë dhe njëkohësisht si një vlerë e paçmueshme e mbarë njerëzimit. Ky libër përmban materiale biografike, fotografi e dokumente për aktivitetin e prijësve fetarë e shpirtërorë shqiptarë të feve të ndryshme, si një dëshmi e gjallë dhe shembull unik i harmonisë dhe i bashkëjetesës ndërfetare për gjithë botën, ku të qenit gjithmonë bashkë për Pashkë e për Bajram, në kremtet e bektashinjve dhe të klerit ortodoks është vetëdijesim, është normë, është domosdoshmëri.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 9 - Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë thotë:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t’i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.[3]

Ndërsa në një hulumtim të bërë nga Shoqata e Sociologëve të Kosovës në vitin 2014 lidhur me per-

ceptimin e opinionit kosovar për religjionin, del se shumica e shoqërisë kosovare mendojnë se askush nuk ka të drejtë t'ia imponojë fenë të tjerëve, çdo njeri duhet të jetë i lirë të praktikojë besimin e tij. Rezultatet e studimit tregojnë se 93% e anketuarve shprehen se askush nuk ka të drejtë t'ia imponoj tjetërkujt gjykimin mbi fenë.

Toleranca ndërfetare tek shqiptarët gjithmonë është mbështetur në vetëdijen kombëtare pasi mbi të gjitha ata kanë një gjak, një gjuhe, kanë të njëjtën prejardhje, kanë kulturën dhe traditën e përbashkët. Qëllimi i pushtuesve tanë si e grekëve, Perandorisë Osmene, sllavëve etj, gjithmonë ka qenë përçarja e shqiptarëve në bazë të feve. Kjo dëshirë e tyre nuk u bë realitet pasi nuk ka ndodhur ndonjë konflikt në baza fetare tek shqiptarët, siç kanë ndodhur të tilla konflikte në të kaluarën në Evropë dhe në disa vende të Azisë.

Mr. Valentina Shala

[1] Sami Frashëri, "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë?", Libri shkollor, Prishtinë, 1999, fq.45
[2] Po aty fq.47
[3] Konventa Europiane per te Drejtat e Njeriut,www.echr.coe.int





Poezi kushtuar anëtarëve të

Ehli Bejtit

Muhamed quhet vula e pejgamberisë,
U dërgua nga Krijuesi i gjithësisë.
Hapat e tij ne duhet që t'i ndjekim,
Ashtu që në rrugë të drejtë të mbesim.
Muhamed! Ti je drita e syve tanë,
E cila nga mbushë plot me iman,
Dashuria për ty nuk matet me mizan.

Fatime quhet vajza më e dashur e Pejgamberit,
Ajo iu caktua Hazreti Aliut si grua e nderit.
Takoi e para prej të gjithëve babanë,
Ishte e para që e la pas Profetit dynjanë.
Model dhe shembull mbeti për të gjitha gratë,
E përshëndesim atë të gjithë me salavatë.

Ali quhet djaloshi që pranoi Islamin si fëmijë,
Lindi në Qabe, askush nuk e kishte fatin e tij,
Ishte ndër të rrallët njerëz që nuk ishin ummijj.
Ishte rritur disa vite në shtëpinë e Profetit,
Besimtarët e njohin si anëtar i Ehli Bejtit,
Ngase martoi Fatimen, si grua të kismetit.
E dhuroi pasurinë në të mirë të Ummetit,
Bëri rojë gjatë natës në shtratin e Profetit,
I cili veçse ishte nisur rrugës së Hixhretit.
Teknikë në luftë tregoi, me Zylfiqar luftoi,
Ai u gradua me dituri, ngase ishte porta e tij.
La pas vetes shumë dëshmi dhe tolerancë,
I bëri ballë armiqve të tij nga çdo distancë,
Bënë atentat në të ata që kishin injorancë.

Hasan quhet një nga nipat e Profetit,
Ai lindi në vitin e pestë të Hixhretit,
Së shpejti do t'i lindte edhe një vëlla,
Ata të dy shndërrisnin sikurse hëna,
Ndaj i donte gjyshi, babai dhe nëna.
E kur Pejgamberi i Zotit namazin e falte,
Loznin mbi shpinën e tij e ai nuk i ndalte.
Muxhteba do të thotë njeri i zgjedhur,
U miratua ngase përkrahës kishte mbledhur.
Xhenneti atë si prijës e kishte përzgjedhur,
Tashmë ndaj tij edhe baltë ishte hedhur.
E dorëzoi pushtetin në të mirën e ummetit,
Befasi e madhe ishte kjo për krerët e shtetit,
Atë më pas e helmuan, ah! ata të shkretit.

Hysejni ishte djali i Fatimes, nip i të Dërguarit,
Yll i pashuar dhe një ndër ata të përgëzuarit.
Serioziteti dhe drejtësia e tij gjithnjë vërehej,
E nga shumë persona filloi edhe që të urrehej.
Jetoi dhe punoi drejtë por u vra në mënyrë mizore,
Ndodhi tragjedia e cila e ndoti historinë njerëzore.

Autor: Besmir Yvejsi, poezi e shkëputur nga libri me poezi fetare dhe atdhetare "U nda hëna", dorëshkrim.

Dobitë nga Ajetul Kursij

Tespih Dova

I Dërguari i Allahut (s.a.a.) citohet nga Ubejji t'i ketë thënë: **"O Ubejj! Urdhëroji muslimanët ta mësojnë suren el-Bekare (brenda saj Ajetit Kursij), sepse mësimi i saj është bekim, kurse lënia e saj humbje dhe asnjë magjistar nuk mund ta mposhtë atë! "**
Ai (s.a.a.) gjithashtu citohet të ketë thënë se:

"Gjithçka ka një kulm dhe kulmi i Kur'anit është surja el-Bekare". "Cili ajet është më i miri në të, o i Dërguari i Allahut?" - e pyetën. Ai u përgjigj: **"Ajeti Kursij [nr. 255]".** Dhe ai ia besoi më të riut ndër sahabët e tij, Harith ibn Zejd ibn el-Harithes udhëheqjen e ushtrisë në mbrojtje të Islamit, në saje të faktit se ai e dinte përmendësh suren el-Bekare.

Imami i gjashtë i Ehli Bejtit, Xhafer es-Sadiku a.s. ka thënë: **"Kur Allahu, Fisniku dhe i Madhërishmi, e urdhëroi Ajetin Kursij dhe dy ajetet e sures Ali 'Imran, që të zbresin në Tokë, ato (ajetet) iu afruan Fronit (të Allahut) dhe thanë: "O Zot! Ku po na dërgon? A po na dërgon neve në vendin (e njerëzve) që e shkelin ligjin dhe bëjnë mëkate?"** Allahu, Fisniku dhe i Madhërishmi, iu shpalli atyre (ajeteve): **"Zbrisni atje se Unë betohem për Madhështinë Time se s'do të ketë asnjë person të vetëm nga pasardhësit e Muhamedit dhe pasuesve të tij, që do t'ju lexojnë juve çdo ditë pas çdo namazi, e që Unë të mos ta vështroj me një vështrim të veçantë shtatëdhjetë herë çdo ditë. Unë do të përmbush shtatëdhjetë dëshira të tyre dhe do t'i pranoj (lutjet e tyre) edhe pse kanë mëkate (në regjistrat e tyre) dhe këto ajete do të formojnë bazën e Librit (Ummul Kitab - që nënkupton suren el-Fatiha).** Ato ajete janë: **Ajeti Kursij i sures el-Bekare dhe surja Ali Imran - ajetet 18 dhe 26.**

Ajeti Kursij, surja el-Bekare, ajeti 255

BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM
ALL-LLAHU LA ILAHE IL-LA HU, EL-HAJ-JUL KAJ-JUM,
LA TE'KHUDHUHU SINETUN VE LA NEUM,
LEHU MA FIS-SEMAVATI VE MA FIL-ERD,
MEN DHEL-LEDHI JESHFEU' INDEHU IL-LA BI IDHNIHI,
JA'LEMU MA BEJNE EJDIHIM VE MA KHALFEHUM,
VE LA JUHITUNE BI SHEJ-IN MIN ILMIHI, IL-LA BIMA SHAE,
VESIA KURSIJ-JUHUS-SEMAVATI VEL-ERD,
VE LA JEUDUHU HIFDHUHUMA, VE HUVEL-ALIJ-JUL ADHIM.

Përkthimi:
Në emër të Allahut , Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Allahu, nuk ka zot pos tij, është i Gjalli dhe i Përjetshmi.
Atë nuk e zë as dremka, as gjumi!
E Tij është gjithë ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë!
Cili është ai që mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij?!
Ai e di se ç'ka para njerëzve dhe ç'ka prapa njerëzve!
Kurse njerëzit dinë nga dituria e Tij vetëm aq sa dëshiron Ai!
Froni (Arshi) i Tij përfshin edhe qiejt edhe tokën dhe,
Atë nuk e mërzit mirëmbajtja e tyre, Ai është i Lartësuar, i Madhërishëm.



Surja Ali Imran, ajeti 18

BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM
SHEHIDALL-LLAHU EN-NEHU LA ILAHE IL-LA HU,
VEL-MELAIKETU, VE ULUL-'ILMI KAIMEN BIL-KIST,
LA ILAHE IL-LA HUVEL-'AZIZUL-HAKIM.

Përkthimi:
Në emër të Allahut , Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!
Allahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij,
E dëshmuan edhe engjëjt e dijetarët dhe se Ai është Zbatues i drejtësisë.
Nuk ka zot përveç Tij, Fuqiplotit e të Urtit.

Ajeti i dominimit, surja Ali Imran, ajeti 28

BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM
KULIL-LAHUM-ME MALIKEL-MULKI,
TU'TIL MULKE MEN TESHAU VE TENZIU'L-MULKE MIM-MEN TESHAU
VE TUI'Z-ZU MEN TESHAU, VE TUDHIL-LU MEN TESHAU BIJEDIKEL-HAJR,
IN-NEKE 'ALA KUL-LI SHEJ-IN KADIR.

Përkthimi:
Në emër të Allahut , Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!
Thuaj: O Allah! Sundues i çdo sendi,
Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do,
E lartëson atë që do dhe e përul atë që do. Çdo e mirë është vetëm në dorën Tënde,
Vërtet, Ti ke mundësi për çdo gjë!".



101 KËSHILLA
për lumturinë bashkëshortore

(Vazhdon nga numri i kaluar i revistës "Vlera")

Martesa e hershme

Meqenëse martesa është një kërkesë e natyrshme, instiktive dhe islame, atëherë duhet që çdo musliman dhe muslimane të realizojë martesën bazuar në udhëzimet islame në moshë të re që të largojë nga ai/ajo, presionin e dëshirës dhe të pasionit dhe kështu të bllokojë një nga dyert e mëdha të shejtanit.

Imam Ali Khamenei thotë: "Pejgamberi, (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij), i konfirmonte rinisë, edhe vajzave, edhe djemve, martesën e hershme, sigurisht me dëshirën dhe zgjedhjen e tyre e jo duke i detyruar. Ne duhet të punojmë që ta promovojmë këtë gjë në shoqërinë tonë. Rinia duhet të martohet në moshën e përshtatshme, para se të kalojë moshën e rinisë, në moshën kur janë aktivë dhe plot dëshirë. Kjo është e kundërta e perceptimit të shumicës së individëve, të cilët mendojnë se martesa në kohën e rinisë është e papjekur dhe e paqëndrueshme. E kundërta është e vërteta dhe realiteti. Nëse martesa bëhet ashtu siç duhet, ajo do të jetë një martesë e qëndrueshme dhe e mirë dhe lidhja ndërmjet gruas dhe burrit do të jetë shumë e afërt". Mësimet islame kërkojnë që martesa të bëhet në kohën e saj, me fjalë të tjera kur të ndjehet nevoja për martesë, sepse sa më herët të jetë, aq më mirë është. Me thënien "sa më shpejt" duhet të nënkuptojmë kohën që djali dhe vajza e ndiejnë se kanë nevojë të martohen, prandaj sa më shpejt të bëhet martersa, aq më mirë është. Arsyeja e fshehtë e kësaj është:

Së pari: Martesa ka begati dhe mirësi që i martuari i arrin në kohën e vet, para se të ikë koha dhe të thyhet në moshë.

Së dyti: Martesa e ndalon revoltën e instinktit seksual. Për këtë është thënë: **"Kush martohet ka ruajtur gjysmën e besimit të tij".** Pra, sipas këtij transmetimi, bëhet mëse e qartë se gjysma e rreziqeve me të cilat përballet besimi i njeriut vijnë nga shpërthimi i instinktit seksual...".

Lehtësimi i martesës

Përderisa Islami e përkrah dhe e mbështet martesën e hershme, atëherë është obligim i shoqërisë islame që të përpiqet për ta lehtësuar martesën e të rinjve dhe të rejave.

Imam Ali Khamenei thotë: "Nëse i shikoni ceremonitë e martesës tek popujt e ndryshëm, do të vini

re se ceremonitë e martesës në Islam janë shumë më të thjeshta. Sigurisht nuk ka ndonjë gjë të keqe kur feston dhe gëzon, por kjo nuk është prej sjelljeve dhe nderimeve zyrtare dhe fetare të martesës sipas parimeve islame. Secili e ka mundësinë të bëjë, ose të mos e bëjë diçka që dëshiron. Por të shkohet te tempujt, të përkulet para një personi, të bëhet ajo që bëhet nëpër ceremonitë që bëhen në vende të tjera, kjo nuk ekziston në Islam. Ajo që ekziston në Islam është një formulë e ligjshme e sheriatit që duhet të lexohet (duaja e niqahut)".

Traditat para Islamit

Imam Ali Khamenei thotë: "Sheriati i shenjtë Islam i ka fshirë traditat dhe kushtet e njohura dhe të përhapura për çështjen e martesës në kohën para ardhjes së Islamit (xhahilijetit). Sheriati i shenjtë ka përcaktuar dhe vendosur një seri urdhëresash, kushtesh dhe traditash të reja. Nëse ne sillemi në një mënyrë që martesa dhe lidhja e saj është e distancuar nga ato gjëra që ka fshirë Islami, nëse martesa është e zbukuruar me traditat që ka themeluar Islami, atëherë edhe lidhja në martesë do të jetë sipas Islamit dhe do të jetë në harmoni me atë që është i kënaqur Pejgamberi i Islamit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij). Mirëpo, nëse fusim në aktin e martesës ato gjëra që i ka larguar Islami, atëherë lidhja martesore do të jetë e dominuar nga injoranca. Ne jemi muslimanë, prandaj nuk duhet të bëjmë vepra të kohës së injorancës (para
Islamit). Nëse nuk kujdesemi që martesën ta ndërtojmë sipas mësimeve të Islamit, atëherë pakti ynë nuk ka për të qenë një pakt i plotë islamik. E nëse pakti është islamik dhe në përputhje me traditat kur'anore që ka vendosur Islami, atëherë jeta jonë do të jetë e bukur dhe bashkëshorti e bashkëshortja do të jetojnë një jetë të mirë e të lumtur".

Lehtësojini problemet, Allahu ju mjafton

Imam Ali Khamenei thotë: "Kur bisedon me rininë ata të thonë: "Në qoftë se ne martohemi në moshë të re, çfarë do të bëjmë më pas?" Këto janë kufizime të cilat pengojnë gjithmonë punët thelbësore dhe të rëndësishme. I Lartësuari thotë: **"Nëse jeni të varfër, Allahu ju begaton nga mirësitë e Tij"**, do me thënë se Allahu i Madhëruar kujdeset për problemet tuaja. Nëse ju martoheni, martesa nuk sjell vështirësi të veçanta për jetën tuaj. Allahu i Lartësuar do t'ju japë prej begative të Tij. Allahu i Madhëruar e thotë këtë. Në qoftë se ne shpenzojmë pa kriter dhe nuk tregohemi kursimtarë, sigurisht që do të na dalin probleme. Nuk duhet të jemi as të shkujdesur e mospërfillës, siç janë ata të pasurit. Njerëzit e pasur e ngrejnë lart standardin e ambicieve, të pasioneve dhe nevojave mashtruese. Po kështu edhe një pjesë e përgjegjësve janë të shkujdesur, megjithëse ata janë të obliguar të shmangin problemet e të shtojnë mundësitë, por ata nuk e bëjnë këtë. Unë dëshiroj të them se qeveritë nuk kanë ndonjë detyrim ndaj rinisë lidhur me martesën e tyre. Por rinia muslimane duhet të qartësohet se martesa është një çështje e domosdoshme, e cila duhet të realizohet. Kur vajzat thonë se nuk janë të gatshme për t'u martuar, apo kur djemtë thonë se akoma jemi të rinj, tregon se nuk kanë fituar mjaftueshëm pjekurinë. Por rinia është e shkëlqyer. Ajo ka përgatitjen e mjaftueshme dhe e kupton se martesa është marrja e përgjegjësive prej të cilave nuk duhet të shmangesh".

Formalizma që çojnë në shpërdorim

Imam Ali Khamenei thotë: "Formalizmat janë një fenomen i dëmshëm për shoqërinë. Ata që i kundërshtojnë formalizmat nuk është se nuk i njohin kënaqësitë e tyre. Përkundrazi, ata i konsiderojnë formalizmat të dëmshme për shoqërinë, njësoj si një ilaç apo një pije e dëmshme. Për shkak të formalizmave të shumta, shoqëria dëmtohet shumë. Nuk do të përbënte problem nëse këto janë brenda kufijve të logjikës, por kur hyn në portën e garimit dhe arrin te shpërdorimi, atëherë ato formalizma dalin nga kufiri i tyre dhe shkojnë në drejtime të tjera".

Po ashtu thotë: "Një pjesë e njerëzve e teprojnë në shpërdorime, kur fare pranë tyre ka plot njerëz që vuajnë edhe për gjërat elementare të jetës. Kushdo që bën shpërdorime të tilla të tepruara dhe të papërgjegjshme është gabimtar".

Dhe: "Një pjesë e njerëzve futen në mëkate me veprën me të cilën mund të merrnin shpërblime, sevape me shpenzimet e tepërta që ata bëjnë dhe me veprat e ndaluara që kryejnë. Edhe përzierja e një vepre të mirë me veprat e ndaluara që ata i kryejnë, është e gabuar. Është e ndaluar shpenzimi i tepërt, shpërdorimi. Është haram edhe djegia e zemrave të njerëzve fukarenj, të cilët kapërcejnë mundësitë e tyre ekonomike që të përgatisin sendet e nusërisë për vajzat e tyre".

Dhe: "Unë i kundërshtoj ata që i vënë të tjerët në

pozita të vështira për të bërë detyrimisht shpenzime të tepërta e të shtrenjta për martesën. Sigurisht, ne e pranojmë festimin dhe gëzimin, por edhe kundërshtojmë ashpër shpërdorimin e tepërt".

Dhe: "Sa e sa të rinj e të reja gjenden, të cilët edhe nëse martohen, mbi ta bie mospërfillja e pasanikëve. Në këto raste ata ndiejnë një mangësi dhe dhimbje. Kështu tek ata krijohet një ndjesi sikur atyre u mungon diçka dhe mallkojnë veten e tyre".

Pjesë e marrë nga libri "101 këshilla për lumturinë bashkëshortore", autor: Sejjid Ali Khamenei, përkthyes: Vullnet Merja, botues: "Shoqata Flladi", Tiranë 2016, fq. 15-23.





Ese nëne



Të imagjinojmë jetë pa frymëmarrje, det pa ujë, zogj pa krahë, male pa drunj, libër pa shkronja, këngë pa melodi, sy pa lot ...

Shihni asnjëra prej këtyre gjërave nuk është e plotë pa tjetrën, kështu do të ishte jeta ime nëse nëna ime nuk do të ishte në të.

Nënë – fjalë që e përdorim çdo ditë. Ta shprehësh këtë fjalë nuk është aq e lehtë. Tash gjithë ju do të mendoni që fjala nënë është fjalë që ka vetëm 4 shkronja, por është fjalë që ka domethënie të madhe. Është fjalë që çdo grua meriton të jetë.

Të jesh nënë domethënë të jesh një botë për një fëmijë, botë që do e injorojë botën e vërtetë, botë që një nënë e ndërton me dashurinë e saj, ajo botë është përqafimi i një nëne.

Kur do të jesh në krahët e saj, të ndjesh paqe, të dëgjosh zemrën e saj, dhe të imagjinosh çfarë do të bëje pa atë dhe sa me fat je që e ke atë në jetën tënde.

Gjithnjë ka pasur një gjë që nuk e kam kuptuar, ajo është pse gjeneratat më të rritura kur i thuhet të shkruajnë për nënën, ato thonë se nuk janë të vegjël.


Unë mendohem dhe e pyes veten: "a ndryshon ndonjëherë dashuria e nënës?" Nëna, ajo që ishte dritë për ty në retë më të errëta, ajo që ishte sup për të qarë, mësuesja më e mirë, shoqja më e mirë. Nëna është çdo gjë që ne dëshirojmë te njerëzit, për shembull: të jenë të sinqertë me ne, sinqerisht të na duan. Gjithmonë themi se këta lloj njerëzish nuk ekzistojnë në këtë planet. Po ja, unë do ju them që ka ata njerëz janë nënat.

Çdo njeri duhet të formojë shoqëri me nënat e tyre, atë që ne kërkojmë prej tyre, t'ua kthejmë në të njëjtën mënyrë. Ka një ditë të bukur në vit, që në atë ditë çdo grua ka buzëqeshje në fytyrë. Ajo ditë është 8-marsi. Shkaku përse e shkruaj këtë ese është t'i gëzoni nënat në këtë ditë sepse ato gjithmonë e meritojnë atë.

Ka edhe një gjë që dua ta ndaj me ju, ajo është: gjëja më e fortë se dashuria e një nëne është vetëm vdekja.


Autore: Amina (Minir) Arsllani

14-vjeçare nga Struga. Është nxënëse në klasën e 9-të në Kolegjin "Yahya Kemal College" në Shkup. Pasioni i saj është shkrimi sepse i pëlqen t'i shpreh ndjenjat në këtë mënyrë. Po ashtu, familja e saj e mbështet shumë në këtë drejtim. Kjo ese është shpërblyer si eseja më e mirë e vitit 2019.



Naim Frashëri
prijës shpirtëror i shqiptarëve dikur dhe sot

"O Zot! Fali Shqipërisë e Shqipëtarëve që i falen emërin Tënd, gjithë të mirat, që ke në jetë dhe mërgoi nga gjithë të ligat. Amin!"



Mexhid Yvejsi

Ata që kanë shkruar e kanë "harruan" se Naimi ishte një besimtar i devotshëm. Si i tillë, ai dëshironte, ai përpiqej, jo vetëm të bëhet Shqipëria, por edhe të ndritohet, të lulëzohet. Të gjitha veprat e Naimit, qofshin në prozë apo në poezi, për të rritur apo për fëmijë, dëshmojnë bindshëm se ai ishte besimtar dhe vepronte si një prijës shpirtëror, sepse në çdo varg, në çdo rresht, në çdo stofë apo në çdo pjesë të shkrimeve ka ide, simbole, porosi hyjnore, profetike, që janë shpresë, burim frymëzimi, mburojë shpëtimi.

Në veçanti, Naimi në librin e tij "Mësime", botuar në Bukuresht, më 1894, e fillon, ejv'Allah, me bismil-lah: "Me emrin e Zotit, Dhembjemath e Mëshirëshumë!"

Kështu fillon Kur'ani i madhërueshëm dhe kështu edhe përfundon. Naimi në librin "Mësime", ndër të tjera, shkruan:

"Dashuria e Zotit është krejt' e urtësisë,
Ata, që duan Zotnë, kërkojnë të vërtetën.
Mësoni dituritë e gjithësisë,
atëherë do kuptoni fuqinë e mirësinë e Zotit.
Gjithë ç'bëri në jetë Zot'i Math e i vërtetë,
e bëri me tmadhe urtësi, me ligje tmbaruarë!
Zoti është Mbret'i gjithësisë!
Drit' e gjithësisë!".

Ndërsa për Kuranin, Fjalën e Allahut, Naimi thotë:

"Kjo fletore është udhërrëfenjës për të mirët,
që s'bëjnë kurrë të ligë dhe besojnë
Zotnë e madh e të vërtetë,
që i falën dhe apënë nga ç'u falë Zoti.
Ata janë dritë e Zotit e të shpëtimit".

Udhëheqësit e shqiptarëve, qoftë ata të politikës apo të kulturës, si dje ashtu edhe sot, me pak përjashtime, e quajnë Naimin, me të drejtë, Apostull i Shqiptarizmit, por sa vlen kjo kur nuk i besojnë Zotit, nuk janë në rrugë të Zotit, kur emrin e Zotit e shkruajnë ende me shkronjë të vogël. Ai është Krijues, Ai është Një, kurse krijesat, emrat e partive të veta, që i krijuan e i ndërrojnë sa herë t'u teket i shkruajnë me shkronja të mëdha! Naimi i quan besimtarët muslimanë, siç ishte edhe vet: "Ata janë dritë e Zotit e të shpëtimit".

Naimi shqip na këshillon: "O njerëz!
Mos u bëni të pabesë, e mos delni
nga udh'e Zotit".

A janë në rrugë të Zotit ata që i kanë ngritur Naimit busta, përmendore, shtatore; shumë rrugë, shkolla e mbajnë emrin e tij të nderuar, por a mjafton kjo, kur nga këto shkolla hyjnë e dalin nxënës pa nxënë, pa mësuar, pa dëgjuar asgjë për Zotin, Krijuesin?! Ka edhe shtëpi botuese me emrin "Naim Frashëri", i cili na këshillon të mos dalim nga Udh'e Zotit, por

nga shtëpia botuese “Naim Frashëri” ende dalin libra kundër Zotit. A kanë mend ata që veprojnë kështu? A janë në udhë të Zotit? Ne, a duhet t’i mbyllim sytë e veshët para zërit, fjalës së Naimit, i cili na këshillon shqip: **“O njerëz! Mos dilni kurrë nga udhë e Zotit e mos u ndani nga e drejta dhe nga e vërteta”.** Këto janë këshillat e Naimit për shqiptarët, nga shkrimi “Thelb’i Kuranit”.

Se poeti Naim Frashëri është poet kombëtar, se është një nga mjeshtërit më të mëdhenj të fjalës shqipe, se është mendimtar i madh dhe Apostull i Shqiptarizmës e pranojnë shumica e lexuesve, studiuesve, sikur e pranojnë se është edukator i kombit shqiptar, që u jepte këshilla të shumta e shumë të vlefshme shqiptarëve, por përse nuk e pranojnë si besimtar dhe si prijës shpirtëror, me edukatë të Islamit, nxjerrë nga Thelbi i Kur'anit?

Këto jo vetëm që s’pranohen, jo vetëm që anashkalohen, por ç’është edhe më keq, ato tjetërsohen, shtrembërohen, shëmtohen, siç bëri prof. Dhimitër S. Shuteriqi, i cili thotë: “Librat shkollorë të Naimit ndihmojnë për të formuar botëkuptimin materialist tek nxënësit. Poeti vërtet fut në këndimet e tij pjesë të ndryshme që predikojnë një moral fetar. Por nga ky moral ai përpiqet të ruaj parimet humanitare të përgjithshme, pa pranuar dogmën dhe përrallat biblike”.

Mjerisht, gati të gjithë studiuesit shqiptarë kështu, si prof. Dhimitër S. Shuteriqi, e shohin Naimin si materialist, ateist, pa menduar për Zotin, Kuranin, madje Thelbin e Kur'anit e quajnë: “dogmë e përralla biblike”! A ndodh kudo kjo? Studiuesit shqipëtarë, intelektualët tanë, me ndonjë përjashtim, ende janë ateistë, pa Zot! Dhe, bota pa Zotin, siç tha poeti gjerman, Ludwing Strauss, ka shumë fytyra, por s’ka sy! Kurse, Naimi, në vargjet në vijim, thotë se Zotin:

“I verbëri s’mund ta shohë,
i dituri mund ta njohë”.

Kur një herë studentët e pyetën të diturin, shkencëtarin, profesorin e nderuar, Louis Pasteur-in, (1822-1895), bashkëkohanik i Naimit, por nga Franca e qytetëruar, se përse beson në Zot, dijetari, shkencëtari L. Paster u përgjigj: “Mu për atë që kam menduar dhe kam studiuar”. Studiuesit shqiptarë as që mendojnë për Zotin, as që kanë studiuar rreth Tij, prandaj nuk e shohin Naimin si besimtar, si prijës shpirtëror, sepse janë të verbër, pa sy, me shumë fytyra, me shumë parti. Naimi, sipas veprave që la, dëshmohet se ishte besimtar dhe prijës shpirtëror i shqiptarëve, që i lutej Zotit me këtë lutje:

“Zot i math e i Vërtetë! Të qofshim falë!
Falna urtësi, njerëzi, vëllazëri, bashkimi,
Udhë Tënde të drejtë, nxirrna në dritë,
mos na lë në errësirë, mërgona nga sharja,
nga vjedhja, nga zilija, nga zemërimi,
e mos na lë kurrë në mundim e në të keqe”.

Naimi, siç shkruante, Kuranin e kishte burim frymëzimi, te Perëndia kishte shpresë:

“Kam shumë shpresë te Perëndia,
Që të mos jetë kështu Shqipëria,
Po të ndritohet, të lulëzohet”.

Naimi i lutej Zotit me këto fjalë:

“O Zot! Fali Shqipërisë e Shqipëtarëve
që i falen emërin Tënd,
gjithë të mirat, që ke në jetë dhe mërgoi
nga gjithë të ligat. Amin!”

Ne, shqiptarët, jo vetëm që s’po falemi në emër të Zotit, aq sa duhet, ashtu siç duhet, por edhe emrin e Tij po e shkruajmë ende me shkronjë të vogël! Naimi, përveç që ishte atdhetar, dijetar, poet kombëtar, s’duhet harruar, sepse bëhemi edhe më horë, se ai ishte një prijës shpirtëror.

Shkruan: Mexhid Yvejsi, marrë pjesërisht nga libri: “101 personalitete fetare-atdhetare, kulturore-letrare”, botues: Instituti për shkencat humane “Ibni Sina”, Prishtinë 2013, fq. 80-92.





Kush e shkatërron **personalitetin e fëmijëve**

Mësimet profetike nga psikologjia islame na mësojnë se nëse fëmijët bëjnë vepra te këqija atëherë prindërit duhet t'u drejtohen në atë mënyrë qe ta shprehë dashurinë e madhe ndaj tyre, se ata e duan shumë, mirëpo nuk ia duan veprat e tij.

Autore: Valentina Shala

Të jesh prind nuk nënkupton vetëm rritjen dhe ushqyerjen e fëmijëve. Ajo që është më e rëndësishmja ka të bëjë me edukimin dhe formimin e personalitetit të tyre. Shpeshherë, nënat dhe baballarët përdorin një qëndrim jo të avancuar të mirësjelljes komunikuese dhe bashkëvepruese me fëmijët. Jo rrallë herë atyre u drejtojnë fjalë, të cilat, fare nuk u kushtojnë rëndësi dhe nuk i vënë në llogari se çka përbëjnë ato në esencë. Kështu, ata nuk e arrijnë dot synimin e natyrshëm edukues e të shëndetshëm të fëmijëve të tyre.

Fjala është thelbësorja dhe esenca e edukatës, si rrjedhojë e kësaj, prindërit gjithmonë iu drejtohen fëmijëve me fjalë, i ulin në bankën e të pyeturit dhe komunikojnë me ta me fjalë; po ashtu i nxisin, i motivojmë ata me fjalë, apo edhe i lavdërojnë dhe i hidhërojnë, gjithashtu me fjalë. Të dhënit edukatë fëmijëve, ndodh ose nëpërmjet fjalëve, ose nëpërmjet veprimeve. Fjala është edukatëdhënie dialoguese, kurse veprimi është edukatëdhënës është jo dialogues dhe ajo që kontribuon në prapambeturi të edukimit është cilësia e ulët e dialogut dhe e trajtimit të fëmijës në aspektin e bashkëveprimit të fjalës!

Shumë nga prindërit përdorin fjalë që prishin disponimin dhe cilësinë e jetës tek fëmijët dhe shumë nga ato fjalë janë investuese për keq në devijimin e mëvonshëm të tyre. Njëra nga këto është ofendimi i fëmijës duke e përshkruar atë dhe duke i ngjitur paturpësisht karakteristikat e kafshëve, si p.sh: "Oj lopë, o kali, o gomar, o hajvan..." Ose vazhdon në ekstremin tjetër dhe e ofendon aq rëndë duke ia mallkuar edhe ditën në të cilën është lindur.

Mos bën krahasime

Fyerja e fëmijëve si p.sh: "Ti je gënjeshtar, i shëmtuar, i trashë, bezdisës" etj., përgjatë synimit të heqjes nga ata të cilësive negative veçse e rëndon më shumë gjendjen psikologjike të tyre. Krahasimi e shkatërron personalitetin e fëmijës, pra të krahasohet ai me një fëmijë tjetër, kjo sepse çdo fëmijë në vetën e tij ka aftësitë, avantazhet dhe talentet e tij, sigurisht, të ndryshme nga fëmija tjetër. Krahasimi, pa mëdyshje që do ta bëjë fëmijën tënd të ndjejë të meta apo ngecje në veten e tij. Veç këtyre, ai e vret edhe vetëbesimin me këtë pesimizëm që e merr dhuratë nga prindërit dhe fillon që të ndjejë urrejtje dhe inat ndaj fëmijës, me të cilën është krahasuar nga ana e prindërve.

Kushtëzimi i fëmijës me kthim të dashurisë, duke ia imponuar një vepër të caktuar, si p.sh.:
“Unë nuk do të të dua për shkak se e bën këtë vepër, por në qoftë se e bën këtë do të të dua, apo nëse do të korrësh sukses!”

Mësimet profetike nga psikologjia islame na mësojnë se nëse fëmijët bëjnë vepra te këqija atëherë prindërit duhet t’u drejtohen në atë mënyrë qe ta shprehë dashurinë e madhe ndaj tyre, se atë e duan shumë, mirëpo nuk ia duan veprat e tij.

Në këtë mënyrë efekti i edukimit kultivohet me dashuri ndaj të mirës dhe shmangie të sigurt ndaj veprave të këqija. Dashuria e kushtëzuar është e papranueshme, ngase dashuria e kushtëzuar e bën fëmijën që të ndjejë se ai është i padashur dhe i padëshiruar, dhe kur të rritet ai do të ndjejë pakujdesje prej familjes, për shkak se gjersa ishte i vogël, ai ishte i padëshiruar për ta, ndaj dhe fëmijët dashurojnë dhe dashurojnë shumë, për shkak se dashuria e tyre është e pakushtëzuar.

Mos ia ndrydhni emocionet e fëmijëve

Në ato raste kur i thuhet fëmijës: “Mos qaj”, “Mos bëj kështu”, “Foshnjërinë e ke lënë pas”, fëmija merr informacion të gabuar dhe kështu atij i ndrydhen emocionet dhe nuk i lihet që të çlirohen e të shfaqen ato. Prindi e zhgënjen fëmijën, duke ia mohuar të drejtën të mendojë, si p.sh.: me shprehjet si: “Mjaft ore”, “Ti s’kupton gjë”, “S’ka dobi nga ti” por në vend se ti thuhet “ mos qajë” prindi duhet ti ofrohet me mëshirë dhe ti thotë “ Pse po qanë” , “ Çfarë të bëjë mami pët ty “ , “ Tu bafsha kurban “ e tjera dhe kështu pra fëmiu fillon që e kuptojë arsyen e të vajtuarit dhe ngadal ngadal fillon të kuptojë se të vajtuarit duhet të ketë një arsye dhe ai fillon të mësohet të mos qajë pa ndonjë arsye.

Le të jemi të kujdesshëm se çfarë fjalë themi e flasim në shtëpitë tona, sepse fjala ka ndikim jashtëzakonisht të madh tek ne. Të zbuluarit e fshehtësirave të fëmijëve përpara të tjerëve ka efekt shkatërrues për personalitetin e tyre, andaj të mos e nënvlerësojmë e nënçmojmë fjalën; të kujdesemi për fjalën përballë fëmijëve tanë, me të cilën ne ua ndërtojmë personalitetin dhe investojmë në zhvillimin e tyre. Me fjalë të mira dhe të matura, ne bëjmë që fëmijët tanë të jenë të plotësuar në të gjitha aspektet njerëzore.

Si përfundim kemi kuptuar që këto janë 5 pikat që e shkatërrojnë personalitetin e fëmijëve:

1. **Fyerja**
2. **Krahasimi**
3. **Kushtëzimi**
4. **Informacioni i gabuar**
5. **Të zbuluarit e fshehtësive etj.**





Nata e Miraxhit

Më 27 Rexheb sipas kalendarit hënor (ose data 15 maj 647 shkurt 621, një vit para Hixhretit) është nata e Mi'raxhit. Sipas dijetarëve muslimanë, është udhëtimi në qiell i Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij), pak para emigrimit të tij në Medine dhe pas vizitës së tij në qytetin Taif.

Mi'raxhi në Kuranin e Shenjtë

Mi'raxhi si term nuk përmendet në Kuranin e Shenjtë por përmendet se Profeti Muhamed (pqmtf) udhëtoi për në xhaminë Aksa (që sot gjendet në Jerusalem):

"I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhamedin) natënnga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t'i treguar atij disa nga mrekullitë Tona".

(Kurani i Shenjtë, surja "El-Isra", ajeti 1).

Dhe dijetarë të tjerë muslimanë thonë që ajetet e sures en-Nexhm (Ylli) na japin gjithashtu informacione mbi udhëtimin e Mi'raxhit:

"Ndërkohë që ai e ka parë atë edhe një herë tjetër,
te Sidretul Munteha-ja,
ku ndodhet Xheneti i Strehimit.
Kur Sidrën çfarë nuk e mbulonte?!
Shikimi i tij nuk u shmang dhe as nuk e kaloi masën,
por ai pa disa nga mrekullitë më madhështore të Zotit të tij!"

(Kurani i Shenjtë, surja En-Nexhm (Ylli), ajetet 13-18).

Mi'raxhi sipas hadithëve të Profetit Muhamed

(paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij)

Nga hadithet e Profetit Muhamed (pqmtf) mësojmë më shumë detaje. Përveç udhëtimit të Mi'raxhit (ngjitja në qiell) është edhe udhëtimi natën (el-Isra). E gjithë ngjarja filloi kur Profeti Muhamed (pqmtf) ishte në Qabe dhe engjëlli Xhibril ia solli atij Burakun (mjetin bartës). Buraku e çoi Profetin Muhamed (pqmtf) në Xhaminë Aksa në Jerusalem dhe atje bëri lutje. Më pas me engjëllin Xhibril udhëtoi në horizontet qiellore ku takoi disa nga profetët e hershëm, Ibrahimin, Musain, Jahjain dhe Isain (paqja qoftë mbi të gjithë). Nga ky udhëzim, Profeti Muhamed (pqmtf) i solli si dhuratë muslimanëve pesë kohët e namazit që vlejnë sa pesëdhjetë kohë.

Një hadith (thënie) e Profetit Muhamed (pqmtf) thotë se:

"Namazi (lutja) është mi'raxh (udhëtim shpirtëror) i besimtarit".

Redaksia VLERA ju uron gjithë muslimanëve kudo që janë këtë natë të madhe të Mi'raxhit.



Peshorja e urtësisë

Bamirësia

"Ndihmojeni njëri-tjetrin në bamirësi dhe devotshmëri, dhe mos ndihmoni nëmëkat dhe armiqësi. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu është ndëshkimfortë" (Surja El-Maide, ajeti 2)

I Dërguari i Allahut (s.a.a.):

"Asgjë nuk e zgjat jetën, pos bamirësia".

(El-Bihar, 77/166/3)

I Dërguari i Allahut (s.a.a.): "Vërtet, dhurata më e shpejtë prej të gjitha veprave të mira është dhuriata e bamirësisë, kurse dënimi më i shpejtë prej të gjitha veprave të këqija është dënimi për dhunë". (El-Hisal, 110/81)

I Dërguari i Allahut (s.a.a.):

"Tri gjëra janë dyert e bamirësisë: zemërgjerësia, të folurit emirë dhe durimi ndaj shqetësimit".

(Tuheful-Ukul, 8)

Imam Bakiri (a.s.): "Katër gjëra (që gjenden tek individi) janë thesar i bamirësisë: fshehja e nevojës (vetjake), fshehja e lëmoshës, fshehja e dhimbjes dhe fshehja e fatkeqësisë". (Tuheful-Ukul, 259)

Shenjat e bamirësit

I Dërguari i Allahut (s.a.a.): "Dhjetë janë shenjat e bamirësit: Dashuron për hir të Allahut, urren për hir të Allahut, shoqërohet për hir të Allahut, ndahet për hir të Allahut, zemërohet për hir të Allahut, është i kënaqur për hir të Allahut, bën për hir të Allahut, kërkon për hir të Allahut, është i penduar para Allahut nga frika, tmerri, pastërtia, sinqeriteti, turpërimi dhe kujdesi, edhe për hir të Allahut bën vepra të mira". (Tuheful-Ukul, 21)

Bamirësia e plotë

I Dërguari i Allahut (s.a.a.): "Plotësia e bamirësisë është të punosh në vetmi atë që bën edhe në publik". (Kenzul-'Ummal, 5265)

Burimi: Muhamedi Rej Shehri, "Peshorja e urtësisë (përmbledhje e haditheve)", Prizren 2010, fq. 56-57.



Frika e arsyeshme dhe e paarsyeshme!

Prindërit nuk duhet të flasin gjithnjë për zjarrin e xhehenemit, por duhet të flasin më shumë për mëshirën dhe mirësinë e Zotit të Madhëruar dhe fëmijën ta edukojnë në mënyrë të atillë që, kur të rritet të ketë shpresë për Xhenetin, ndërsa dhe të ketë frikë nga Xhehenemi.

Frika, më pak ose më shumë, ekziston tek të gjithë njerëzit. Frika është e nevojshme për mbrojtjen e njeriut. Frika është njëra prej begative të Zotit, për arsye se njeriu e shpëton veten prej rreziqeve të shumta, por këtë begati duhet shfrytëzuar në mënyrë të saktë. Frika është dy llojesh: 1. Frikë e paarsyeshme; 2. Frikë e arsyeshme.

Frika e paarsyeshme

Frika e paarsyeshme si p.sh.: frika nga xhinët, errësira, frika nga shtazët të cilat nuk sjellin dëm, si p.sh.: macja, bretkosa, kali, deveja dhe të tjera, ose frika nga hajnat, nga i vdekuri, nga mjeku, injeksioni dhe ilaçet, nga vetëtima, nga provimet e të tjera të ngjashme. Nëse fëmijën e frikësojmë nga gjëra të tilla, ai gjithnjë do të jetë në frikë dhe mjerim, madje dhe në gjumë do të ëndërrojë gjëra të rrezikshme.

Personi frikacak kurrë s'ka kurajë që të marrë përsipër kryerjen e punëve të rënda. Gjithnjë është i dëshpëruar dhe i ndrojtur. Prindi ose edukatorja e mire nuk duhet ta frikësojnë fëmijën pa ndonjë arsye. Nëse dëshironi që fëmija juaj të mos bëhet frikacak duhet ndjekur këshillat e mëposhtme:

1. Gjatë zhurmave të forta, siç janë: vetëtima e bubullima, mos e ngrini zërin pranë fëmijës por silluni si në gjendje të zakonshme.

2. Mos i frikësoni fëmijët nga fantazmat, siç janë: divi, gogoli, vampiri.

3. Mos iu drejtoni fëmijës me zë të lartë dhe mos i frikësoni ata duke i rënë murit (tavolinës) me dorë.

4. Është e mundur që vetë prindërit të jenë frikacakë. Në këtë rast ata së pari duhet shëruar veten tyre. Largoni frikën e paarsyeshme nga vetja juaj dhe përballë gjërave të frikshme mos u tregoni frikacak, që fëmija juaj të mos e ndiejë se ju keni frikë.

5. Shikimi i filmave me policë, tregimi i ngjarjeve dhe tregimeve të frikshme ndikon në shpirtin e pastër të fëmijës, prandaj mundohuni që t'i mbani larg skenave të tilla fëmijët tuaj. Nëse fëmija është bërë frikacak për shkak të neglizhencës suaj mos rrini duarkryq, por përpiquni ta largoni frikën e tij. Asnjëherë mos e kritikoni dhe përqeshni fëmijën frikacak dhe mos e turpëroni atë në prani të tjerëve, por me durim dhe vëzhgim zbuloni faktorët e frikës dhe nxitoni me shërimin e tyre.

Fëmijës suaj bëjani me dije se gjërat si: divi, gogoli dhe vampiri janë gënjeshtra. Xhindët nuk kanë punë me njerëzit. Nëse fëmija juaj frikësohet nga shtazët e padëmshme, afrohuni afër asaj shtaze dhe prekeni atë me dorë në mënyrë që përmes këtij veprimi atij t'i bëhet e qartë që kjo shtazë nuk është aspak e rrezikshme. Nëse fëmija frikësohet nga errësira, merreni atë pranë vetes dhe pastaj për disa moment fikeni llambën duke e siguruar atë që nga errësira nuk duhet frikësuar. Duhet ditur se asnjëherë nuk bën të përdorni kërcënime dhe ndëshkime për fëmijën e frikësuar.

Nëse fëmija frikësohet nga mjeku dhe marrja e injeksioneve, me fjalë të qeta dhe me dashuri, ia bëni të qartë atij se nëse dëshiron që të shërohet duhet t'i marrë injeksionet dhe t'i pijë ilaçet. Përveç kësaj, kur është i shëndoshë, dërgojeni atë nganjëherë në spital (ambulancë) në mënyrë që të ambientohet me të.

Frika e arsyeshme

Prindërit duhet t'ua sqarojnë fëmijëve rreziqet eventuale. T'i parandalojnë ata nga këto rreziqe, gjithashtu t'ua tregojnë atyre rrugën e shpëtimit. Kështu, p.sh., duhet t'ua mësojnë atyre mënyrën e drejtë të përdorimit të shkrepsës, gazit dhe pajisjeve të ndryshme elektrike. T'ia përmendim rreziqet tjera të mundshme, t'ia mësojë mënyrën e drejtë të kalimit të rrugës dhe ta vë në dijeni atë për rregullat e komunikacionit rrugor.

Një prej rasteve të frikës është frika nga vdekja. Fëmija, deri në një moshë, nuk është në gjendje ta perceptojë kuptimin e vdekjes dhe është e preferuar që prindërit dhe edukatoret të mos flasin lidhur me këtë temë me fëmijët e tyre. Por kur të rriten dhe kanë pare ose kanë dëgjuar për vdekjen e njerëzve përqark ose të familjarëve të tyre, mund të ndodhë të kenë frikë nga vdekja ose i vdekuri. Këtu është e nevojshme që prindërit t'ua bëjnë atyre me dije se vdekja nuk është ndonjë gjë e frikshme dhe me rëndësi.

Njeriu kur vdes kalon nga kjo botë në një botë tjetër, e cila është bota e Ahiretit, në të cilën botë do të pranojë shpërblimet për veprat e mira dhe ndëshkimin për veprat e këqija. Vdekja nuk është ndonjë gjë e frikshme, e rëndësishme është që njeriu të mos u shkaktojë dëme të tjerëve, por të kryejë vepra të mira, në mënyrë që pas vdekjes të jetë i lumtur. Prindërit nuk duhet të flasin gjithnjë për zjarrin e xhehenemit, por duhet të flasin më shumë për mëshirën dhe mirësinë e Zotit të Madhëruar dhe fëmijën ta edukojnë në mënyrë të atillë që, kur të rritet të ketë shpresë për Xhenetin, ndërsa dhe të ketë frikë nga Xhehenemi.

Huazuar nga libri për fëmijë: "Si t'i edukojmë fëmijët tanë", libri i dytë, autor: Abdulfazl Beni Ahmedi, përktheu: Valbona Horozova, botues: "Sh. K. "Kur'ani", Prizren 2008, fq. 15-20.



15 thënie të arta për durimin

-Durimi është dritë.

-Durimi është një rrugë me gjemba, nëse e kalon, arrin atë që dëshiron.

-Duro pak sepse pas vështirësisë ka lehtësim, dhe çdo gjë ka kohën dhe caktuesin e saj.

-Durimi është dy llojesh: durimi ndaj asaj që e urren dhe durimi për atë të cilën e dëshiron.

-Koha është e ndarë në dy ditë, një për ty e njëra kundër teje. Në ditën tënde mos u trego dembel, e kur të jetë kundër teje duro.

-Durimi është çelësi i rrugëdaljes.

-Durimi është me goditjen e parë.

-Bëni durim, durimi në besim është si koka në trup, nuk ka mirësi ai trup i cili nuk ka kokë, e as ai besim që nuk është i pajisur me durim.

-Kush bën durim ka fituar gjithçka.

-Nuk ju ka dhënë ndonjërit mirësi më e gjerë sesa durimi.

-Durimi është veshja më e bukur e njeriut.


-Durimi është si anija me të cilën kalojmë detin e streseve dhe na çon drejt bregut të rehatisë.

-Ai i cili nuk shpëton prej durimit, do të shkatërrohet prej mosdurimit.

-Nëse falënderimi dhe durimi janë dy dete, nuk do të më interesonte se cilës prej tyre do t'i hipja.

-Nëse hyn në diskutim me injorantin, duhet të durosh fjalët e tij.





PYETJE
dhe përgjigjje



PROF. DR. SHEJH EIDI EKBER

Prof.Dr. Ekber Ejdi

Pyetje

Paqja qoftë me ju, Shejh i nderuar.

A është mundur që njeriu të jetë të njëjtën kohë edhe sufi edhe ndjekës i Ehli Bejtit a.s., pra që njeriu ta ndjek Ahkamin (Rregullat), Tefsirin (Komentimin e Kur'anit), Akaidin (Besimin), Fikhun (Jurisprudencën) e Ehli Bejtit a.s., ndërkohë që të jetë pjesëtarë i ndonjë tarikati që bën ziqër, sikur bëjnë sufijtë, që ta pasoj ndonjërin prej Piranëve (Themeluesve) të tyre etj.?

Përgjigje

Në emër të Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëplotit.
Paqja qoftë me ju.

Burimi i të gjithë arifëve duhet patjetër të jetë Libri i Zotit dhe Sunneti i të Dërguarit, s.a.v.a., dhe ky është rregulli që vlenë për çdo besimtar. Imamët e Ehli Bejtit, a.s. nuk sjellin asgjë nga vetja, ndërkohë që obligimi i tyre mund të përmblidhet në dy gjëra. E para përkon me interpretimin e drejtë dhe të pagabueshëm të fjalëve të Zotit dhe Sunnetit të të Dërguarit s.a.v.a. Gjëja tjetër përkon me parandalimin e shtrembërimit dhe të interpretimit të gabuar të fjalëve të Zotit dhe Sunnetit të të Dërguarit s.a.v.a., andaj këto dy obligime hyjnore mund të përmblidhen si detyrim për udhëzim të drejtë në raport me Kur'anin dhe Sunnetin e të Dërguarit s.a.v.a.

Imamët e Ehli Bejtit përmes lutjeve, transmetimeve dhe apeleve i kanë shpalosur realitetet më të lartësuara të irfanit duke i sqaruar në këtë mënyrë rrugët deri në nivelet më të larta shpirtërore.

Sufijtë gjithashtu përpiqen që përveç dimensionit sheriatik, apo të jashtëm, ta ndjekin edhe dimensionin e brendshëm, andaj nuk ka kurrfarë pengese që njeriu të merr pjesë në tubimet e tyre, ndërkaq të qenit ndjekës i Ehli Bejtit nuk prish punë fare.

Natyrisht se duhet qenë i vëmendshëm në atë që muridi (kërkuesi sufi) të mos e braktisë dimensionin e vet racional dhe të ndalojë së menduari, ngase me atë rast mund të themi se kjo nuk është e pranueshme nga këndvështrimi i Kur'anit, Sunetit të të Dërguarit s.a.v.a. dhe Imamëve a.s..

Nëse njeriu pushon së menduari, irfani i tij nuk do të jetë i vërtetë e as që ai do të bëhet arif i cili është i lidhur me Islamin.

"Për ata që Allahun e përmendin në këmbë, ulur dhe të shtrirë dhe që persiasin rreth krijimit të Qiejve dhe Tokës..." *(Surja Ali 'Imran, ajeti 191).*

Prandaj, arifi i vërtetë është besimtar, musliman i cili me dy krahët – përsiatjen dhe ziqrin – udhëton drejt Allahut të Lartësuar. Ju uroj çdo të mirë!

Sociologët kanë një emër për këtë ide. Ata e quajnë atë "teza e sekularizimit". Tani, hulumtimet sugjerojnë se historia është më e ndërlikuar.



Në 1822, **Thomas Jefferson** sugjeroi një version të hershëm të tij, duke parashikuar se unitarianizmi "do të jetë, për një kohë të gjatë, feja e shumicës nga veriu në jug". Disa të dhëna nga vendet moderne mbështesin tezën.

Pesëdhjetë vjet më parë, rreth 4 nga 10 fëmijët në Angli ndoqën shkollën e së dielës kurse sot është vetëm rreth 10%. Në vitin 1972 në Shtetet e Bashkuara, 95% raportuan rreth përkatësisë së tyre fetare dhe vetëm 5 % e popullsisë nuk raportuan rreth përkatësisë fetare. Në vitin 2016, 1 nga 4 thanë se nuk kishin përkatësi fetare.

Hulumtimet e fundit, megjithatë, kanë sugjeruar se feja është më e qëndrueshme se sa ishte menduar më parë. Përderisa pjesëmarrja në kishë ka rënë ndjeshëm në Evropën Perëndimore, sekularizimi ka qenë më pak i dukshëm në Shtetet e Bashkuara. Numri i amerikanëve që e rendisin përkatësinë e tyre të kishës si "asnjë" është rritur, por më shumë se 70% ende e identifikojnë përgjithësisht si të krishterë.

Konsensusi i ri i sociologëve dhe demografëve është se modernizimi dhe sekularizimi janë vërtet të lidhura, por në mënyra komplekse.

Një studim i publikuar këtë javë nga Qendra Kërkimore e Pew mbi marrëdhënien në Shtetet e Bashkuara midis religjionit dhe nivelit arsimor (një komponent i modernizimit, së bashku me ndryshimet teknologjike dhe të tjera) në shikim të parë duket të mbështesë tezën e sekularizimit: Sa më shumë njerëz të arsimit, aq më pak fetare janë.

"Të diplomuarit e kolegjit kanë më pak gjasa të thonë se besojnë në Zotin me siguri absolute", vuri në dukje studiuesi kryesor Pew Gregory Smith. "Ata kanë më pak gjasa të thonë se feja është shumë e rëndësishme në jetën e tyre. Ata kanë më pak gjasa të thonë se luten rregullisht dhe të diplomuarit e kolegjit kanë më shumë gjasa se të tjerët të identifikohen si ateistë dhe agnostikë".

Një vështrim më i afërt i të dhënave, megjithatë, ofron një pamje më të nuancuar. Ndërsa çifutët me arsim të lartë kanë tendencë të jenë më pak të vëmendshëm sesa çifutët më pak të arsimuar, raporti ndërmjet edukimit dhe besimit fetar është më i dobët mes atyre amerikanëve me një identitet të fortë kristian.



Pse feja është më e qëndrueshme

Gjersa shoqëritë bëhen më moderne, feja humbet kontrollin e saj. Njerëzit e ndajnë

Rritja e mprehtë e numrit të amerikanëve që nuk raportojnë lidhje fetare mund të ketë gjithashtu një shpjegim që nuk lidhet me sekularizimin. Hulumtimet nga Philip Schwadel në Universitetin e Nebraskës thonë se është më pak e pranueshme 50 vjet më parë të identifikoheshe si jo-religjioz se sa është sot, pra ishte më e vështirë të ishe i pa fe në atë kohë se sa është sot.

Schwadel dhe të tjerë gjithashtu argumentojnë se ka dallime të konsiderueshme midis Shteteve të Bashkuara dhe Europës kur bëhet fjalë për procesin e sekularizimit. Në Evropë, feja e organizuar në përgjithësi është shoqëruar me qeveritë në



se mendimi i zakonshëm në shoqërinë moderne?

fenë e tyre nga institucionet e tyre dhe nga pjesët e jetës së tyre.

një shkallë shumë më të madhe se sa në Shtetet e Bashkuara. Si rezultat, ndjenja anti-qeveritare mund të ketë qenë më e mundshme në Evropë për të prodhuar antagonizëm ndaj kishës. Mbështetja e qeverisë për fenë në shumë vende të Evropës Perëndimore mund të ketë dobësuar vitalitetin e atyre komuniteteve të kishës.

"Kur një shtet krijon një marrëdhënie me një fe, udhëheqësit fetarë nuk kanë më një nxitje të njëjtë për të dalë dhe për t'i bërë njerëzit të ngazëllyer", tha Schwadel. "Ata marrin para nga shteti përmes taksave, kështu që ata nuk duhet të mbledhin para nga kongregantët e tyre".

Në Shtetet e Bashkuara, në të kundërt, udhëheqësit fetarë duhet të "nguten" më shumë, tha Schwadel.

"Ata duhet të marrin më shumë kongregacione nëse kisha e tyre do të mbijetojë." Ndoshta si rezultat, amerikanët janë më të angazhuar se evropianët në kongregacionet e tyre të kishave.

Nocioni se besimi dhe praktika fetare kanë evoluar me modernizim, mbeten pjesërisht të pranuara. Me rritjen e shkrim-leximit dhe njohurive shkencore të avancuar, shpjegimet e mbinatyrshme për zhvillimet në botën natyrore janë bërë më pak të rëndësishme. Megjithatë, feja ka mbijetuar, argumenton Schwadel, sepse ajo luan rol të ndryshëm.

"Feja u siguron njerëzve shumë më shumë sesa thjesht shpjegime për botën natyrore", tha Schwadel. "Ai siguron komunitetin, i siguron ata me miq, i siguron mbështetje psikologjike dhe mbështetje ekonomike, dhe siguron shumë më tepër sesa thjesht një kuptim se ku janë në botë në lidhje me jetën e përtejmë".

Një studim i vitit 2016 zbuloi se më shumë amerikanë kanë raportuar ndjenja në rritje të "spiritualitetit", madje duke thënë se ata ishin më pak të lidhur me fenë e organizuar. Në masën që kishat i përgjigjen kësaj nevoje, ata ndoshta do të kenë shanse më të mira për mbijetesë.

Pyetja që udhëheqësit fetarë dhe sociologët e fesë përballen është nëse modernizimi përfundimisht do të çojë në sekularizim në Shtetet e Bashkuara dhe në vende të tjera, ashtu siç ka në Evropën Perëndimore. Disa argumentojnë se një theks i zvogëluar në doktrinën tradicionale për kuptimin e shpëtimit, për shembull, ose ekzistenca e qiellit dhe ferrit, është thjesht një shenjë e hershme e laicizmit në rritje.

Ndër pesimistët për të ardhmen e fesë është shkrimtari Rod Dreher, libri i ri i të cilit është "Opcioni Benedikti" përshkruan një strategji mbijetese për të krishterët "në një komb pas krishter".

"Unë jam duke shkuar në kolegje të ndryshme, katolike dhe ungjillore, duke dhënë fjalime, dhe në çdo një nga këto kolegje, profesorët më tregojnë të njëjtën gjë," tha Dreher. "Fëmijët janë fëmijë të mirë, por ata vijnë nga familjet [dhe] kishat lokale dhe ministrat e të rinjve, duke mos ditur pothuajse asgjë rreth besimit historik të krishterë".

Dreher tani është i bindur se Shtetet e Bashkuara "janë në të njëjtën rrugë rënëse në drejtim të respektimit të fesë që Evropa ka qenë për një kohë të gjatë".

"Është e gjitha për emocion," tha ai.
E huazuar nga Interneti.

Metoda e Kuranit në psikoterapi



"...Allahu nuk e ndryshon të ardhmen e asnjë populli, deri ai të ndryshojë veten e tij..." (Surja er-Ra'ad, ajeti 11).

Pesë gjëra me të cilat zgjidhen të gjitha problemet tona psikike

Ndrysho mendimin për një çështje që të mundon.

Ballafaqohu me problemin (kërko ndihmën e ekspertit)

Mos ik nga problemi por mundohu ta zgjidhësh.

Ndrysho kahjen e prirjeve tua për një çështje.

Ndrysho qëndrimin tënd në zgjidhjen e problemit. (konsultohu me njerëz të mençur)

Për të bërë rregullime apo ndryshime në sjelljen e një personi është e domosdoshme që në fillim të veprohet me rregullimin ose ndryshimin e prirjeve të tij. Njeriu është nën ndikimin e mendjes dhe të prirjeve.

Për këtë arsye, qëllimi kryesor i psikoterapistëve është ndryshimi i llojeve të ndryshme të mendimeve, që kanë të sëmurët psikikë për veten e tyre, për njerëzit dhe për jetën. I sëmuri psikik, me ndryshimet e mendimeve që ndodhin nën efektin e trajtimit, bëhet i fuqishëm për të përballuar problemet. Shpeshherë, pas shërimit, e kupton se problemet e shkuara bëheshin shkak i shqetësimeve dhe i sëmundjeve të tij.

Në thelb, mësimi është praktikë që në rrjedhë të tij rregullon dhe ndryshon mendjen, prirjet, zakonet dhe sjelljet e njerëzve. Puna e psikoterapisë, në të vërtetë, është korrigjim i mësimeve të gabuara të shkuara. I sëmuri, si rrjedhojë e mendimeve të gabuara rreth vetes, rreth të tjerëve dhe rreth jetës, është përballur me ankthe.

Psikologu përpiqet që t'i korrigjojë mendimet e pacientit dhe atë e detyron që të përballet me realitetin e tij dhe të njerëzve të tjerë. Në vend të arratisjes nga problemet, ai duhet të përballet me to. Gjithashtu, në vend që të vazhdojë të jetë i lidhur me gjendjen e ngatërruar psikike – që është pengesë e zgjidhjeve të problemeve – të përpiqet

që t'i zgjidhë ato. Ky ndryshim qëndrimi e bën pacientin të fuqishëm përballë vetes dhe njerëzve dhe e bën atë më të fuqishëm për zgjidhjen e problemeve. Përfshirja psikike dhe ankthi largohen prej tij. Zakonisht, kjo bëhet shkak i lumturisë së pacientit dhe një fillimi aktiv të ri në jetën e tij. Njeriu e ndien shijen e jetës, kënaqësinë e shpirtit, qetësinë dhe lumturinë.

"...Allahu nuk e ndryshon të ardhmen e asnjë populli, deri ai të ndryshojë veten e tij..." (Surja er-Ra'ad, ajeti 11).


Kurani ka zbritur për ndryshimin e mendjeve, të prirjeve dhe të sjelljeve të njerëzve, për udhëzimin e tyre në të drejtë dhe në të mirë, për shpëtimin nga humbja e rrugës së drejtë dhe injoranca, për të gjetur mendime të reja rreth karakterit dhe qëllimit të njeriut, për të treguar vlerat e moralit dhe shembujt e lartë. Kurani bëri ndryshime të mëdha në përgjithësi, që në themelimin e një sistemi të ri shoqëror, të jetës personale të njeriut, si dhe ndikimin e pakundërshtueshëm që pati në shoqëri. Shkurtimisht, mund të thuhet se në mes të gjithë Librave të Zotit që janë zbritur gjatë historisë, Kurani është i pranueshëm dhe i pazëvendësueshëm. Në një kohë të shkurtër, Kurani arriti të nxirrte personalitete mjaft të larta, të plota, të drejta, të qeta dhe të sigurta në vetvete. Ata mundën që të ndryshonin në mënyrë të jashtëzakonshme, të tundnin botën dhe të linin gjurmë të thella në histori.

Lind pyetja: Si mundi Kurani ta ndryshonte psikologjinë dhe personalitetin e arabëve?

(Vazhdon në numrin e ardhshëm të revistës Vlera)
Huazuar nga libri: "Kurani dhe Psikologjia", autor: Muhamed Uthman Nexhati, përktheu: Redis Sheko, botues: "Fondacioni i Kuranit", Tiranë 2013, fq. 294-296.

Lulet e Prillit

O ju lule të shumëngjyrta
Të mbuluar me një freski joshëse pranverore
Pa më thoni kush ju ka krijuar?
Kush ju dha këtë bukuri?
Kush jua dha këtë aromë?
Kush ju dha këto ngjyra të bukura?
Që e zbukuroni botën tonë
E ti moj atmosferë kaltëroshe
Që e mbanë në lartësi
Diellin e verdhë si flori
Që në horizontet e tua
Fluturojnë zogjtë e gëzuar
Pse nuk më thua kush të ka krijuar?
Më dëgjoni vallë,
O ju lule
O ju zogj
O ti qiell kaltërosh
Pse s'më thua kush të ka krijuar?
Na krijoi Zoti, thanë lulet e prillit
Na krijoi Allahu, thanë zogjtë e qiellit
Na krijoi Perëndia, tha dielli me rrezet e tij





Studenti **Ateist**

Studenti tha: “Zoti nuk ekziston.”

Shoku i tij iu përgjigj: “Si e thua këtë gjë, kush ta ka mësuar?

Studenti tha: “Unë nuk mund ta mohoj se shkolla është ajo e cila ma mësoi këtë gjë, që më shpëtoi prej zakoneve dhe më çoi në horizontet e gjera të diturisë. Dhe, përsa i përket, se nga e ka burimin kjo thënie, unë them se nuk e kam parë Zotin dhe çdo gjë e padukshme nuk ekziston.”


Shoku tha: “Unë nuk dua të diskutoj me ty rreth fakteve të tua por unë të pyes: A ke shëtitur në planete? A ke shkuar në polin e veriu e të jugut? A ke shkuar në thellësitë e detrave?
Studenti u përgjigj: “Jo.”

Shoku: “Nëse një person të thotë ty se Allahu ndodhet në planete apo në thellësi të detit apo në polet si do ti përgjigjesh atij?”
Studenti u mendua thellë dhe nuk u përgjigj.

Shoku tha: “Është nga padituria që njeriu të mohojë diçka që nuk e ka parë dhe as nuk ka dëgjuar për të. Disa njerëz, para se të shpikej makina, aeroplani, radioja, telefoni, energjia, televizioni etj., nëse dëgjonin për to ngrinin zërat kundra atyre që i thonin këto gjëra dhe talleshin me ta, fjalët e tyre i merrnin qesharake. A kishin të drejtë të vepronin në këtë mënyrë?

Ata thonin se nuk i kishin parë ato gjëra. Edhe ti je i njëjtë me ta kur thua se nuk e ke parë Zotin.

Studenti: “Unë të falënderoj për vërejtjen dhe të falënderoj shumë sepse më shpëtove nga thënie të pavlera të cilat i mbolli në mendjen time profesori jobesimtar që kur hyra në shkollë. Tani unë e mësova të vërtetën.



Bashkudhëtari i haxhit

Një burrë ishte kthyer nga haxhi dhe po i tregonte Imam Sadikut (pqmt) si e kishte kaluar udhëtimin dhe për bashkudhëtarët Ai lavdëronte shumë njërin prej tyre. Të gjithë ishin të kënaqur që po shoqëroheshin më një burrë të nderuar si ai. Ai gjatë tërë kohës falej dhe lutej. Sapo mbërrinim në ndonjë shtëpi, ai shkonte në një cep, shtronte sexhade e tij. dhe fillonte të falej.

Imami e pyeti:
“Po, kush i bënte atëherë punët e tij? Kush përkujdesej për kafshën e tij?”

Burri iu përgjigj: “Sigurisht, nderi i këtyre punëve na takonte neve, ai ishte i zënë vetëm me punët e tij të shenjta.” “Atëherë, të gjithë ju qëndroni me lart se ai”, - u përgjigj imami.

Tregime nga Mesnevi-ja



Mos i trego askujt

Një burrë i shkretëtirës duke ecur në shkretëtirë me devenë e tij e has një burrë që po vdiste nga etja. Burri i kishte kërkuar ujë për hir të Zotit. Ai kishte zbritur nga deveja dhe i kishte dhënë ujë. Burri që piu ujin e shtyu burrin e shkretëtirës, hipi në deve dhe filloi të ikë. Burri i shkretëtirës nga pas bërtiti: "Në rregull, po ma vjedh devenë, mirë- po kam një lutje nga ti. Mos i trego askujt për këtë që ndodhi". Hajduti pa e kuptuar kërkesën u ndalë dhe e pyeti: "Përse".

Njeriu i shkretëtirës iu përgjigj: "Nëse i tregon dikujt, kjo përhapet nga goja në gojë dhe më asnjëherë njerëzit e shkretëtirës, nuk ndalen t'i ndihmojnë atyre që kanë nevojë në shkretëtirë".

Gara e bretkosave

Një ditë po bëhej një garë në mes të bretkosave. Qëllimi i garës ishte të hipnin në majën e një kulle. Një masë bretkosash ishin mbledhur për ta shikuar garën. Gara kishte filluar. Kulla ishte aq e lartë saqë shikuesit nuk besonin se ndonjëra nga garueset do të arrinte të hipte mbi të. Në vend që t'i përkrahnin filluan të bërtasin: "Të gjorat, asnjëra nuk do t'ia arrijë!"

Bretkosat që filluan garën ranë pré e pesimizmit dhe duke menduar se nuk do të arrinin të dalin mbi kullë, një nga një u larguan nga gara, përveç një bretkose që me inat ngjitej drejt kullës. Shikuesit vazhdonin të bërtisnin: "Të gjorat, asnjëra nuk do të ia arrijë!" Bretkosa e mbetur në fund, e cila nuk kishte lënë garën, kishte treguar durim dhe kishte arritur të ngjitej në majë të kullës. Shikuesit dhe bretkosat e tjera të habitura kishin dashur të dinin se si e arriti kullën. Një bretkosë iu afrua dhe e pyeti: "Si e arrite këtë?"
Bretkosa që ishte ngjitur në kullë nuk kishte dhënë përgjigje. Atë moment ishte kuptuar se ishte e shurdhër. Bretkosa duke mos dëgjuar fjalët pesimiste të shikuesve dhe duke mos u bërë vetë pesimiste, por vetëm duke menduar të ngjitej në kullë, më në fund ia kishte arritur.

Tri mësimet

Tri mësimet që kam marrë në kohën e fundit janë:

I pari, nga një hajdut. Duke ecur në mal humba rrugën. E rastisa atë. E luta që të më pranonte një natë mysafir. Më tha se ishte hajdut dhe nëse kjo nuk më pengonte, mund të rrija. Në vend që të rrija një natë, qëndrova një muaj. Në çdo mëngjes, në orën e njëjtë dilte për punë. Kur kthehej e pyesja: "Si shkuan punët sot?" Ai thoshte gjithnjë: **"Sot ishte keq, por do të provoj nesër përsëri"**, pra, ai nuk bëhej pesimist asnjëherë. Mua ma mësoi këtë gjë: **"Nesër është një ditë e re, ndoshta e arrij cakun tim".**

I dyti, nga një qen. Kisha dalë skaj liqenit për të ecur. Pashë një qen të etur duke u përpjekur të pinte ujë. Qeni kur pa vetën në ujë u frikësua dhe iku. Por, për të mposhtur frikën u gjuajt në ujë. Pastaj piu ujë derisa iu shua etja. Nga qeni mësova këtë: **"Ta mposhtësh frikën".**



I treti, nga një fëmijë. Një fëmijë shkonte diku me një qiri të ndezur në dorë. Ju ofrova dhe e pyeta: **"A e di burimin nga vjen drita".** Ai duke fikur flakën e qiriut më tha: **"Më s'ka dritë. Tani, më thuaj ti se ku iku drita?"** Mbeta gojëhapur. Nga ai mësova: **"Të mos shes mend gjoja se di diçka".**

Përktheu nga turqishtja: Fatijona Bajraj



Shqiptarja me mbulesë islame ligjëruese në Universitetin e Bazelit

Arlinda Ahmeti 28-vjeçare nga Maqedonia, ka lënë gjurmë në Zvicër me suksese në fushën e dijes. Ajo zotëron tetë gjuhë të huaja dhe është ligjëruese në Universitetin e Bazelit.

Arlinda është koordinatore e programit të doktoraturës **"Islami dhe Shoqëria: Studime Teologjike Islame" në Qendrën Zvicerane për Islamin dhe Shoqërinë (SZIG).** Ajo erdhi në Zvicër në vitin 2000 si një dhjetëvjeçare me familjen e saj shqiptare nga Maqedonia.

Ajo studioi studimet islame dhe studimet Iberoroman në Universitetin e Bazelit. Si pjesë e tezës së doktoraturës në SZIG të Universitetit të Freiburgut, ajo po studion bashkësinë shqiptaro-muslimane në Zvicër, e cila është grupi më i madh mysliman në këtë vend.

Në një intervistë, ajo tha se qëllimi i saj është të zhvillojë një vetinterpretim islamik në universitet që duhet të gjejë vendin e saj në shkencë, në Islam dhe në shoqërinë zvicerane. Kjo kontribuon në integrimin e myslimanëve dhe tregon se sa interpretime të ndryshme të Islamit janë negociuar mes traditave dhe kërkesave kontekstuale.

Mund të vërehet se Islami shpesh perceptohet dhe përfaqësohet me një normë të sheshtë. Meqenëse ekziston një nivel i lartë interesi në temat e Islamit në shoqëri dhe shpesh edhe një kureshtje e madhe, shohim mundësinë për të trajtuar jo vetëm shkencëtarët, por edhe grupe të synuara shumë të gjera në shoqëri me temat tona kërkimore.

Shumica e myslimanëve që jetojnë në Zvicër, me rreth 40 për qind, janë shqiptarë, të ndjekur nga boshnjakët, me rreth 20 për qind. Myslimanët me origjinë shqiptare dhe vende të tjera të Ballkanit vijnë nga Evropa. Ata kanë përvojë të bashkëjetesës me të krishterët dhe hebrenjtë.

Që nga viti 2000, ka pasur një prani në rritje të myslimanëve shqiptarë në debatin zviceran të Islamit. Peizazhi mysliman në Zvicër është shumë heterogjen, prandaj përfaqësuesit e ndryshëm kanë fjalën e tyre. Edhe muslimanët shqiptarë janë shumë të ndryshëm: ekzistojnë "xhamitë kosovare", bordi i të cilave përbëhet kryesisht nga kosovarët dhe "xhamitë maqedonase-shqiptare", bordi i të cilëve përbëhet nga shqiptarët e Maqedonisë. Vizitorët e xhamisë janë përsëri shumë heterogjenë dhe shpesh vijnë nga vende të ndryshme të origjinës.



9 IDE
për rregullimin e ballkoneve



1.Mendoni për përdorimin e ballkonit

Ballkonet janë hapësira ideale për ngrënie. Nëse jeni person I cili ka dëshirë të ftojë miq për t'ju shtruar darkë, atëhere duhet menduar se sa do te jetë numri I planifikuar I ulëseve në ballkonin tuaj për të akomoduar mysafirët. Nëqoftë se pëlqeni të punoni me laptopin tuaj në ambiente të jashtme, duhet menduar për hijëzim adekuat që të mos ketë reflektim si pengesë në ekranin tuaj. Përcaktimi I llojit të aktivitetit I cili do të bëhet në këtë hapësirë është kyç për zhvillimin e me tutjeshëm të dizajnit.

2. Kontrolloni se sa peshë mund të mbajë ballkoni juaj

Ballkonet janë pjesë kritike në ndërtesat tona kur flitet për peshën pasiqë mbingarkimet shkaktojnë dëmtime sktrukturore dhe riparime të kushtueshme, ose dhe më keq, lëndime. Nëse po mendoni të vendosni vazo të medha me lule, fillimisht bëni hulumtimin se sa mund të përballojë ballkoni juaj.

3. Planifikoni hapësirën

Pasi të keni bërë hulumtimin mbi qëndrueshmërinë e ballkonit tuaj, mund të bëni një vështrim mbi hapësirën që posedoni dhe të planifikoni se si të shfrytëzoni pjesën më të madhe të saj. Hapësirat e vogla mund të shndrrohen në hapësira multifunksionale nëse mendohet mirë se si të rradhiten mobiljet, bimët dhe pajisjet tjera me kujdes. Sigurohuni që hapësira të mos jetë shumë e mbi ngarkuar dhe se gjerat si skara të jenë të pozicionuara në vende të sigurta dhe larg nga materialet e ndezshme.

4. Caktoni stilin që kërkoni

Ballkoni juaj duhet konsideruar si zgjerim I shtëpisë suaj. Në qoftë se ju pëlqen stili minimalist, planifikoni të vendosni orendi skandinave. Montimi I luhatëseve gjithashtu do t'I sjell atraktivitet ballkonit tuaj. Mund te eksperimentoni me fenerë dhe jastekë të lloj-llojshëm por duhet caktuar me kujdes ngjyrat të cilat po I përdorni. Percaktohuni për ngjyra neutrale nëse dëshironi që ngjyra e bimëve të jetë fokusi I ballkonit tuaj.

5. Lloji I ulëseve dhe tavolinës

Në qoftëse hapësira është e limituar, gjetja e një kompleti të karrigeve ideale mund të duket e ndërlikuar në fillim. Çelësi është tek caktimi I duhur I madhësisë, këndit dhe komoditetit. Materialet

duhet të jenë të përshtatshme nësë ato lagen nga shiu, ose të paktën të kenë një mbulesë për raste të tilla. Karriget të cilat palosen jane ideale per hapesira të vogla, mirëpo sigurohuni të jenë komode për qëndrim. Testoni këndin e ulëseve dhe provoni se si është raporti me tryezën të cilën ju do ta bleni.

6. Si të zgjedhni materialet e përshtatshme

Mjaft me rëndësi është mundësia e vendosjes dhe largimit të pjesëve të buta, siç janë sfungjerët, kur është nevoja, nga ballkoni juaj. Për të bërë hapësirën sa më të rehatshme dhe relaksuese, materialet e buta dhe të mbushura janë ideale. Nëse mendoni të leni materiale jashtë gjatë gjithe kohes, sigurohuni që lagështia mos t'I dëmtojë.

7. Çfarë lloj bimësh duhet të blini?

Bimët të cilat kërkojnë mirëmbajtje të pakët janë lloji më I mirë për një ballkon. Të jetuarit në qytet shpesh do të thotë të punosh shumë orë gjatë ditës, dhe bimët tuaja duhet të jenë më shume një burim kënaqësie dhe relaksi se sa një punë në shtëpi. Erëzat e ndryshme si origano, borziloku, menta nuk kërkojnë kujdes të madh, dhe përveq aromës së mirë të cilat ato lëshojne, ju mund t'I përdorni ato dhe në gatimet tuaja.





8. Si të krijoni privatësi

Bimët janë gjithashtu një mënyrë e mirë për të krijuaj privatësi në ballkone. Shtreterit në nivel më të ulët se muri I ballkonit mund të konsiderohen si ide për të pasur privatësi. Panelet nga bambuja ose kallami gjithashtu shfrytëzohen për të krijuar murë ndarëse dhe hijë në këto raste. Mund të vendosen dhe perde të përkohshme të cilat shfrytëzohen për të arritur efektin e tillë.

9. Ndriçimi

Mbrëmjet mund të bëhen shumë lehtë atraktive me ndriçimin e duhur. Qirinj në gota apo kavanozë janë ide e mirë për të krijuar një atmosferë të rehatshme në netët e verës. Fenerët mund të kombinohen me qirinj për të arriturr dritën e sfondit që të baraspeshohet me dritën qëndrore (shembull; mbi tavolinë). Përderisa ju keni një furnizim adekuat dhe të papërshkueshëm nga uji, llambat e projektuara posaçërisht për ambiente të jashtme mund të përdoren gjithashtu.

Revistën Vlera mund ta gjeni
në të gjitha kiosket e Kosovës.

SHTËPIA BOTUESE
DIELLI PAS REVE



Të nderuar lexues!

Redaksia mirëpret përgjigjet tuaja për anketën e re të revistës Vlera

- Cili shkrim ju pëlqen më shumë ?
- Çfarë tematikisht mendoni se duhen shtuar në revistë ?
- Cila rubrikë mendoni mund të rrisë numrin e lexuesve të revistës ?

Na shkruani në:
vlera.magazine@gmail.com

DOLI NË SHITJE LIBRI
"JASINI ME SHKRONJA SHQIPE"

Jasini është sure e preferuar për begati dhe mbrojtje.
Jasini është në gjuhën arabe, shqipe me përkthim dhe në gjuhën arabe por me shkronja shqipe. Gjithashtu në fund të librit keni mësime të palexuara deri tani.

Librin mund ta gjeni në Bibliotekën e Institutit "Naim Frasheri" në Prishtinë, ose ta porositni përmes e-mailit
vlera.magazine@gmail.com apo numrit 044 142 038 (Viber)

ADRESA: SHQËPIA BOTUESE "DIELLI PAS REVE"
RR. RRUSTEM STATOVCI 29 – PRISHTINË.



ZIJARET NË QERBELA

OFERTË SPECIALE

PRISHTINË – STAMBOLL – QERBELA

VAZHDON NË MUAJIN SHTATOR 2019

BILETA E AEROPLANIT, VIZA, VIZITAT,
& HOTELI (PANSION I PLOTË).

VIZITA E VENDEVE SI:

QERBELA, NEXHEF, KUFE, BAGDAD, KADHIMIJE

Oferta përfshin vizitën e këtyre vendeve
të shenjta turistike.

Qerbela
- Mauzoleu (tyrbja) dhe xhamia e Imam Husejnit
- Xhamia e Hazreti Abbasit dhe tyrbet
  e të gjithë shehidave të Qerbelasë
- Shetitje nëpër qytetin e Qerbelasë

Nexhef:
- Xhamia e madhe e Imam Aliut
- Xhamia dhe Mihrabi i martirizimit
  të Imam Aliut në Kuffe.
- Shtëpia dhe bunari i Imam Aliut në Kuffe.

Bagdad:
- Xhamia dhe mauzoleu i Hazreti Abdul-Kadir
  Xhejlaniut (themeluesi i tarikatit Kadiri)
- Xhamia dhe mauzoleu i Imam Ebu Hanifes
  (themeluesi i medh'hebit/shkollës juridike Henefi)

Basra:
- Xhamia dhe mauzoleu i Pirit Ahmed Rufai në Basra

TELEFON VIBER
+38344142038

EMAIL
qerbela.ks@gmail.com

Zijaret ne Qerbela

